

FONDI

SIGAL INVEST

PROSPEKTI

2025

INFORMACION I RËNDËSISHËM PËR FONDIN E INVESTIMIT

Fondi i Investimit SIGAL INVEST (në vijim “Fondi”), është një sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, i themeluar nga SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. (në vijim “Shoqëria Administruese”), shoqëri administruese e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “AMF”), për të administruar fonde të pensionit privat dhe sipërmarrje të investimeve kolektive. Shoqëria administruese e zhvillon aktivitetin e saj me ndershmëri, transparencë dhe profesionalizëm në interesin më të mirë të investitorëve.

Fondi i investimit me ofertë publike është një grupim i veçantë asetesh, pa personalitet juridik, i krijuar në bazë të një marrëdhënieje kontraktuale, pas licencimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, dhe i administruar nga shoqëria administruese, me qëllim grumbullimin e aseteve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave të fondit.

Shoqëria administruese është subjekti juridik qeverisës i fondit të investimit, që e administron dhe e përfaqëson atë në lidhje me palët e treta. Asetet e fondit investohen në përputhje me parimin e diversifikimit të rrezikut dhe dispozitave të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”. Mbajtësit e kuotave kanë të drejtën jo vetëm të marrin pjesë në mënyrë proporcionale në fitimet e fondit, por edhe të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave që zotërojnë.

Prospekti përmban të gjithë informacionin e nevojshëm dhe kryesor në lidhje me fondin, në mënyrë që investitorët potencialë të jenë në gjendje të vlerësojnë objektivat dhe strategjitë kryesore të Fondit të Investimit SIGAL INVEST, rreziqet specifike të lidhura me investimin në fond, si dhe tarifat dhe pagesat e Fondit.

INFORMACION I RËNDËSISHËM PËR FONDIN E INVESTIMIT

Prospekti përmban të gjithë informacionin e konsideruar thelbësor në kontekstin e objektivit të investimit dhe shoqëria administruese deklaron që ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm që informacioni që përmban ky Prospekt, të jetë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi dhe që nuk ka përjashtim të informacioneve që mund të ndikojnë mbi domethënien e tij. Informacioni i dhënë në këtë Prospekt është shprehur ndershmërisht e në mënyre transparente për të orientuar investitorët.

Çdo opinion ose parashikim i përmendur në këtë prospekt nuk ka për qëllim keqinformimin e investitorit.

Prospekti nuk përbën një ftesë për të blerë kuota të Fondit por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat dhe rreziqet e lidhura me pjesëmarrjen në Fond.

Çdo investitor potencial këshillohet të lexojë këtë Prospekt në mënyrë që të kenë një informacion të qartë mbi karakteristikat dhe rreziqet e fondit përpara se të marrin vendimin për të investuar.

Emri i Fondit	SIGAL INVEST
Licencuar	Në datë 28/02/2023 me nr. licence 13 me vendim Bordi të AMF nr. 17
Shoqëria Administruese	SIGAL UNIQA INVEST – Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.
Publikuar	Në datë --- <u>10/03/2025</u>

Tabela e përmbajtjes

PËRKUFIZIME	6
SHOQËRIA ADMINISTRUESE	8
Forma ligjore.....	8
Fondet nën administrim.....	9
FONDI I INVESTIMIT SIGAL INVEST	15
Politika e Investimit.....	16
Vendet e Ekzekutimit.....	23
Transaksionet e ri financimit të titujve	24
Faktorët e rrezikut	24
SHUMA MINIMALE E INVESTIMIT DHE VLERA FILLESTARE E KUOTËS	31
TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT E FONDIT	31
KUSHTET E BLERJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE.....	32
Blerja e kuotave	32
Shlyerja e kuotave.....	33
Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes së kuotave	34
Transferimi i kuotave	35
VLERËSIMI I ASETVE DHE ÇMIMIT TË KUOTËS	35
ADMINISTRIMI I FITIMIT PËR MBAJTËSIT E KUOTAVE	36
INFORMIMI I INVESTITORËVE.....	37
TARIFAT DHE KOMISIONET	37
Tarifa e Administrimit	37
Tarifat të Tjera	38
KOMISIONE/TARIFA TË TJERA QË PAGUHEN NGA ASETET E FONDIT.....	38
TRAJTIMI FISKAL	39
AUDITI I JASHTËM	39
DEPOZITARI.....	40
Konflikti i interesit	41
BASHKIMI DHE MBYLLJA E FONDIT	42
Bashkimi i fondit me një fond tjetër	42
Mbyllja e fondit	42
VITI FINANCIAR AKTUAL	43
INFORMACION PLOTËSUES.....	43
Konflikti i interesit	43
Kujdesi	44
Ankesat.....	44
Rregullat e fondit të investimit SIGAL Invest	45

FONDI I INVESTIMIT SIGAL INVEST

DEKLARATA E KUJDESTARIT	50
DEKLARATA E INVESTITORIT	51
FORMULAR I BLERJES SËKUOTAVE NË FONDIN E.....	52
INVESTIMIT SIGAL INVEST	52
INFORMACION RRETH INVESTITORIT	53
INFORMACION RRETH PERSONIT TË TRETË QË INVESTON NË EMËR TË INVESTITORIT.....	54
DEKLARATË E INVESTITORIT:	55

PËRKUFIZIME

AMF: është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Aksione: Tituj të transferueshëm që përfaqësojnë një pjesë të pronësisë së investitorit në një shoqëri tregtare, me pritshmëri marrjen e një pjese të fitimeve në formën e dividendëve, ose të përfitimit nga rritja e çmimit të aksioneve të saj, ose të dyja.

Asete: tituj, instrumente të tregut të parasë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

Depozitari (Banka Kujdestare): “Depozitari” është banka e licencuar nga Autoriteti rregullator/AMF të kryejë si veprimtari ruajtjen e pasurisë së sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe e cila ka detyrat dhe funksionet e parashikuara në ligjin “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” nr. 56/2020” (në vijim “Ligji për SIK”);

Diversifikimi i portofolit: investim i aseteve të Fondit në instrumente të ndryshëm, në mënyrë që të zvogëlohet rrezik u nga investimi;

Emetues: është personi juridik ose çdo subjekt tjetër juridik i rregulluar me ligj, përfshirë Qeverinë ose një organizatë financiare ndërkombëtare të miratuar, i cili emeton tituj;

FATCA: ligj federal i SHBA, i cili u kërkon të gjithë institucioneve financiare të huaja t’i raportojnë Agjencisë së të Ardhurave në SHBA (IRS) informacionin mbi llogaritë- financiare të taksapaguesve amerikanë, ose të entiteteve të huaja në të cilat taksapaguesit amerikanë zotërojnë një përqindje të rëndësishme;

Fond investimi: sipërmarrje e investimeve kolektive e themeluar si fond kontraktor, me objekt të vetëm sigurimin e kapitalit nga investitorët dhe investimin e këtij kapitali në lloje të ndryshme investimesh, sipas një politike të miratuar për investimet, me qëllim realizimin e përfitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit të investimeve.

Investitor: subjekti që ka në pronësi kuota në një fond investimi;

Këshilli i Administrimit: duke iu referuar ligjit për shoqëritë tregtare, është i vetmi organ administrimi i shoqërisë aksionare, i cili ushtron njëkohësisht funksione administrimi e mbikëqyrjeje (sistemi me një nivel);

Kohëzgjatja e modifikuar: tregues i ndjeshmërisë së çmimit të një letre ndaj ndryshimeve në normat e interesit;

Kohëzgjatja e modifikuar e portofolit: mesatarja e ponderuar e treguesve të ndjeshmërisë së çmimit të letrave me vlerë individuale që përbëjnë portofolin e investimeve;

Komisioni (tarifa) vjetor i administrimit: është tarifa periodike që i paguhet shoqërisë administruese të sipërmarrjes së investimeve kolektive, e përlllogaritur çdo ditë në bazë të një përqindjeje vjetore, sipas vlerës së pasurisë së çdo sipërmarrjeje ose nënfondi.

Komisioni (tarifa) i hyrjes: është komisioni që nënshkruesi i paguan subjektit operator të sipërmarrjes së investimeve kolektive, në momentin e nënshkrimit të pjesëmarrjes në sipërmarrje.

Komisioni (tarifa) i daljes: është komisioni që nënshkruesi i paguan subjektit operator të sipërmarrjes së investimeve kolektive në momentin e shlyerjes së pjesëmarrjes në sipërmarrje.

Kthimi nga investimi: rezultati që merret nga investimi i aktiveve dhe fitimi nga kapitali; Kthimi nga investimi është raporti që krahason fitimin dhe humbjet nga një investim në raport me kostot e tij.

Kuotë: është çdo pjesëmarrje e barabartë përpjesëtimore, që rezulton pas pjesëtimit të interesave përfitues në aktivet, objekt i sipërmarrjes së investimeve kolektive të fondit të investimeve.

Kuota akumulimi: kuotat e një fondi për të cilin të ardhurat nga investimi ri- investohen automatikisht dhe përfitimet për investitorët vijnë nga akumulimi i vlerës së atyre kuotave;

Marrëveshje e riblerjes (Repo): marrëveshje ku shitësi i letrave me vlerë, pranon t’i blejë ato përsëri në një kohë dhe me çmim të paracaktuar;

Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes (Reverse Repo): marrëveshje ku blerësi i letrave me vlerë, pranon t’i shesë ato përsëri në një kohë dhe me çmim të paracaktuar;

Obligacion: është titull afatmesëm ose afatgjatë borxhi, me afat maturimi më të gjatë se një vit, që detyron emetuesin t’i paguajë zotëruesit të obligacionit vlerën nominale dhe interesin në një apo disa këste, në një datë të caktuar;

Ofertë publike: është ofrimi i titujve publikut të gjerë pa kufizim;

Periudha minimale e investimit: periudha e investimit fillon në momentin e blerjes së kuotave të fondit dhe zgjat deri në momentin e depozitimit në Fond të një kërkesë të vlefshme për shitjen e këtyre kuotave.

Portofol investimi: tërësia e investimeve të kryera me asetet e fondit;

Prospekt: dokumenti i shkruar, ku përcaktohen kushtet e ofertës të sipërmarrjes së investimeve kolektive;

Rregullat e Fondit: dokumenti i rëndësishëm, i cili konsiderohet kryesor dhe ka për qëllim të rregullojë ligjërisht marrëdhënien midis Shoqërisë Administruese dhe mbajtësve të kuotave (investitorëve) në Fond;

Rreziku i Kreditit: është mundësia që një investim në obligacione ose instrumente të tjera me borxhe të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të tij financiare, si pagesat e interesit dhe shpërblimet e principalit. Ky rrezik është i lidhur ngushtë me cilësinë e borxhit të lëshuara nga emitentët dhe mund të ndikojë në kthimet e përgjithshme të fondit. Fondet e investimeve që investojnë në obligacione dhe instrumente të tjera të borxhit janë të ekspozuara ndaj këtij rreziku, i cili mund të ndryshojë në varësi të ndryshimeve në klasën e kreditit të emitentëve dhe kushteve të tregut financiar.

Këto rreziqe mund të jenë të menaxhueshme përmes diversifikimit të portofolit dhe vlerësimit të kujdesshëm të cilësisë së borxhit në të cilin investohet.

Sipërmarrje investimesh kolektive (SIK): është çdo formë organizimi lidhur me çdo lloj pasurie, përfshirë monetare, qëllimi i së cilës është mundësimi i personave që marrin pjesë në këtë formë organizimi ("pjesëmarrësit"), të bëhen pronarë të pasurisë ose të një pjese të saj, të përfitojnë fitime ose të ardhura që rrjedhin nga marrja, mbajtja, administrimi ose shitja e pasurive ose shumave të paguara nga këto fitime ose të ardhura;

Sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur: sipërmarrja e cila në bazë të dokumentit themelues shlyen pjesëmarrjet çdo ditë pune, sipas një çmimi të llogaritur në bazë të vlerës neto të aktiveve për pjesëmarrje të sipërmarrjes, të përcaktuar në përputhje me ligjin;

Standardi i Përbashkët i Raportimit (CRS): përbën një kërkesë rregullatore për raportim për Institucionet Financiare të vendosura në juridiksionet pjesëmarrëse dhe ka qëllimin për të shmangur evazionin fiskal;

Shkëmbimi automatik i informacionit për llogaritë financiare (AEIFA): Ligji nr.4, miratuar nga Kuvendi i RSH në 30/01/2020;

Shoqëria administruese: është subjekti i themeluar, veprimtaria tregtare e të cilit është administrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, e licencuar në zbatim të ligjit nr. 56/2020 dt. 30/04/2020 ose të një ligji të barasvlershëm të huaj në fuqi;

Shuma minimale e mbetur në fond: vlera minimale e llogarisë në fond, nën të cilën llogaria mund të mbyllet;

Shlyerja: është veprimi i transferimit të "titujve dhe çmimeve të tyre përfundimtare" midis dy palëve. Palët në transaksione me tituj përmbushin detyrimet që rrjedhin prej tyre, përfshirë detyrimin për të dorëzuar, transferimin e çmimit ose transferimin e titullit mbi instrumentet financiare midis palëve;

Tituj: janë instrumente financiare, të cilat emetohen për qëllime fitimprurëse nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre dhe janë të tregtueshme. Titujt përfshijnë pa kufizim aksionet e emetuara nga shoqëritë aksionare, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të njëjstëve të vetëqeverisjes vendore, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga qeveritë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumentet e tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që përkufizohen si të tilla në këtë ligj.

Tituj të borxhit: janë obligacione ose forma të tjera titujsh borxhi të transferueshëm, me përjashtim të instrumenteve financiare që janë ekuivalente me aksionet e shoqërive tregtare ose që, nëse konvertohen ose nëse ushtrohen të drejtat që rrjedhin nga to, krijojnë të drejtën e blerjes së aksioneve ose instrumenteve financiare ekuivalente me aksionet;

Treg i rregulluar: sistemi shumëpalësh që shfrytëzohet dhe/ose administrohet nga një subjekt operator tregu, i cili bashkon ose ndihmon në bashkimin e interesave të shumtë të shitblerjes që kanë të tretët për instrumente financiare, në përputhje me rregulloret e detyrueshme të tij. Instrumentet financiare pranohen për tregtim sipas rregulloreve dhe/ose sistemeve të tregut të rregulluar dhe ai licencohet, regjistrohet ose njihet nga AMF. Ky përkufizim përfshin gjithashtu tregjet mbi banak, ku titujt janë emtuar dhe garantuar nga Qeveria Qendrore e Republikës së Shqipërisë, me kusht që shitja të njihet dhe të rregullohet nga AMF, si dhe të jetë e hapur ndaj publikut;

Tregu i parasë: Tregu i parasë i referohet tregtimit në instrumente borxhi afatshkurtra;

Vlera neto e aseteve: vlera e agreguar e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive në momentin e llogaritjes;

Vlera neto e aseteve për kuotë: vlera neto e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, e pjesëtuar me numrin e kuotave në emetim në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve;

Vlerësimi i rrezikut të kreditit: vlerësimi lidhur me besueshmërinë e aftësisë paguese të një subjekti, një borxhi ose një detyrimi financiar, një titulli borxhi, një aksioni me përparësi ose një instrumenti tjetër financiar, ose të një emetuesi të një borxhi apo detyrimi financiar, titulli borxhi, aksioni me përparësi ose instrumenti financiar dhe që jepet mbi bazën e një sistemi të afirmuar dhe të përcaktuar të kategorive të rrezikut.

SHOQËRIA ADMINISTRUESE

Forma ligjore

SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a., është një shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me seli: Rr."Ukraina e Lirë", pas Kullave Binjake, ndërmjet Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë, me Numër Unik të Identifikimit K61423001P.

SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a., është licencuar me vendim nr. 50 datë 30/03/2011 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrim të aktivitetit në tregun e fondeve të pensionit privat dhe me vendim nr. 95, datë 28/04/2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrim të aktivitetit në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Shoqëria Administruese mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9572, datë 03/07/2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ligjit nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe Ligjit nr. 56/2020 dt. 30/04/2020, “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Shoqëria Administruese ka si objekt të aktivitetit të saj:

Veprimtarinë e mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensionit privat, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, bazuar në licencën nr. 2, datë 30/03/2011, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën nr. 2, datë 28/04/2022, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria administruese vepron në mënyrë të rregullt, korrekte dhe në përputhshmëri me parashikimet ligjore gjatë kryerjes së veprimtarive të saj. Shoqëria përdor aftësitë dhe dijet e nevojshme, vepron me korrektësi dhe me kujdesin e duhur. Ajo përdor me efektivitet burimet dhe procedurat e nevojshme në mënyrë që të ushtrojë veprimtaritë e saj në mënyrë të shëndoshë. Gjithashtu, shmang konfliktet e interesit në mënyrë që të garantojë që interesat e investitorëve në secilën prej sipërmarrjeve të investimeve kolektive të administruar nga shoqëria e administrimit të fondeve të kenë përparësi dhe të qëndrojnë mbi interesat e aksionarëve të shoqërisë administruese të fondeve dhe interesat e punonjësve të saj ose të çdo personi të lidhur me të.

Fondet nën administrim

Shoqëria administruese ka nën administrim:

- **Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL MAX PENSION**
- **Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION**
- **Fond Investimi me Pjesëmarrje të Hapur me Ofertë Publike SIGAL INVEST**

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL - është fond pensioni me pjesëmarrje të hapur i themeluar në bazë të Vendimit datë 17.12.2010 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Administruese dhe miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendim nr. 51, datë 30.03.2011. Monedha bazë e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL është Lekë.

Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO - është fond pensioni me pjesëmarrje të hapur i themeluar në bazë të Vendimit nr. 4, datë 04.07.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Administruese dhe miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendim nr. 251, datë 20.12.2022.

Monedha bazë e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO është Lekë.

Fondin e Investimit me Pjesëmarrje të Hapur me Ofertë Publike - SIGAL INVEST licencuar me vendim nr. 17 datë 28.02.2023 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Shoqëria Administruese mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat" dhe ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Shoqëria Administruese gjatë punës së saj vepron me ndershmëri, kujdesin e duhur e profesionalizëm, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikat më të mira.

Organet Drejtuese

të Shoqërisë Administruese janë:



Adrian Totokoçi, Kryetar



Edvin Hoxhaj, Anëtar



Abdyl Sarja, Anëtar



Klement Mersini, Anëtar



Elvis Ponari, Anëtar

Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga këta përfaqësues ligjorë të shoqërisë:

-Edvin Hoxhaj, Shoqëria “SIGAL LIFE”

-Avni Ponari, CEO SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë:

Adrian Totokoçi	Kryetar
Abdyl Sarja	Anëtar
Edvin Hoxhaj	Anëtar
Klement Mersini	Anëtar
Elvis Ponari	Anëtar

PËRBËRJA E ORGANEVE DREJTUESE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Shoqëria administruese ka dy aksionarë:

- Shoqëria e Sigurimeve “SIGAL Life UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. 51% të aksioneve
- Z. Avni PONARI 49 % të aksioneve

Organet Drejtuese të Shoqërisë Administruese janë:

I. Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga këta përfaqësues ligjorë të shoqërisë:

1. Edvin Hoxhaj, Shoqëria “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a.
2. Avni Ponari, CEO SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.

II. Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit përbëhet nga 5 anëtarë:

- | | | |
|------------|----------|---------|
| 1. Adrian | Totokoçi | Kryetar |
| 2. Abdyl | Sarja | Anëtar |
| 3. Edvin | Hoxhaj | Anëtar |
| 4. Klement | Mersini | Anëtar |
| 5. Elvis | Ponari | Anëtar |

Këshilli i Administrimit ka kompetencë kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese, miraton politikat financiare dhe politikat e investimit, emëron dhe shkarkon administratorët ose anëtarët e komitetit të investimit. Këshilli i Administrimit angazhohet që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit.

Z.Adrian Totokoci, vjen nga një eksperiencë e gjatë në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë, me përvojë në pozicione drejtuese në institucione shtetërore të tregtisë së jashtme.

Z. Totokoçi është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1980-1985). Z. Totokoçi ka kryer studime pasuniversitare në Universitetin e Manhattan-it (1992-1993) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Aktualisht ai është:

Administrator i Përgjithshëm, Kompania ALTO Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Toyota në Shqipëri. Administrator i Përgjithshëm, Kompania AVEL Sh.p.k, Përfaqësuese Zyrtare e Markës Peugeot në Shqipëri, Anëtar Bordi i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Japoni.

Z. Adrian Totokoci nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z.Abdyl Sarja, në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Juridik të shoqërisë më të madhe të Sigurimeve

në Shqipëri “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. ka një përvojë të mirë të vendosjes së standardeve organizative e ligjore të shoqërisë.

Z. Sarja prej vitit 2013 është Sekretar i Përgjithshëm i “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. Ai është diplomuar si Jurist në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (1996-2000). Z. Sarja ka titullin master në Të Drejtat Evropiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Francë (2003-2004) dhe Titulli i Avokatit (që nga viti 2005). Gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë saj. Pas diplomimit, Z. Sarja ka punuar si Avokat Specialist pranë Këshillit të Qarkut, Tiranë (2000-2002); si Specialist në Sektorin Juridik në Departamentin e Mbështetjes Profesionale; (2002-2004), si Përgjegjës i Sektorit Juridik (2004-2005) dhe në fund si Drejtor i Drejtorisë Ligjore dhe Licencimit të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve (sot Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) (2005-2006). Z. Sarja është anëtar bordi i SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. Kosovë (që nga viti 2008) dhe Kryetar i Komitetit Ligjor të Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë. Ai ka shërbyer edhe për dy mandate si Anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Z. Abdyl Sarja nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z. Edvin Hoxhaj, Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. me një eksperiencë të pasur në fushën e sigurimeve në përgjithësi dhe atë të jetës e risigurimeve në veçanti. Z. Edvin Hoxhaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik (1984-1988). Ai ka ndjekur Studime Postuniversitare për Vlerësimet e Pasurive të Paluajtshme në Universitetin Politeknik, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, në vitet 1993-1994.

Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht mbi Sigurimet (Jo Jetë dhe Jetë) dhe Risigurime si dhe për Menaxhim Biznesi.

Z. Hoxhaj e filloi karrierën e tij në industrinë e sigurimeve duke punuar në Institutin e Sigurimeve të Shqipërisë në Korrik 1992, ku ka mbajtur disa pozicione: Menaxheri i Zyrës së Sigurimit të Pronës (1992-1996); Drejtor i Departamentit Motorik (1996-1998) dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës (1997-1999). Nisur nga përgatitja e plotë dhe përvoja e tij e gjatë, Z. Hoxhaj është kontribues në disa subjekte në tregun e sigurimeve në vend dhe në Ballkan.

Aktualisht është anëtar bordi i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. (që nga viti 2008); anëtar i Bordit Këshillimor të SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a., Kosovë (që nga viti 2012) dhe anëtar i Bordit Këshillimor të UNIQA Life a.d. Shkup (që nga viti 2014) Maqedonia e Veriut.

Z. Edvin Hoxhaj nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z. Klement Mersini ka një formim e eksperiencë të pasur në fushën financiare.

Aktualisht, Z. Mersini mban postin e Drejtorit të Departamentit Financiar në kompaninë më të madhe të Sigurimeve në Shqipëri SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a.

Z. Mersini është diplomuar pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në degën Financë – Kontabilitet (1994-1998), ndërsa ka vijuar studimet pasuniversitare dhe aktualisht është kandidat për PhD. Z. Mersini është Kontabël i Miratuar (që nga viti 2002) dhe Ekspert Kontabël i Autorizuar (që nga viti 2010). Ai gjithashtu ka marrë disa kualifikime dhe trajnime në Shqipëri dhe jashtë vendit, kryesisht për mbikëqyrjen dhe raportimet në shoqëritë e sigurimit, menaxhimin e rrezikut, menaxhimin e aktiveve, Solvency 2, IFRS 4, IFRS 17, etj.

Z. Klement Mersini nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

Z.Elvis Ponari është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group Austria” sh.a.. Z. Ponari është inxhinier financiar me arsim pasuniversitar, zotëron master në Administrim Biznesi (MBA) në banka dhe sigurime dhe master shkencor (MSc) në Financë. Me një eksperiencë 10 vjeçare në sigurime në Vjenë, Austri, ku ka mbajtur pozicionin si Drejtor Rajonal në UNIQA Group Austria. Gjithashtu, Z. Elvis Ponari ka dhe një eksperiencë 3 vjeçare si drejtues në Bankën e Shqipërisë dhe më pas në rolin Drejtues Ligjor i kompanisë vendase ALBGAZ. Aktualisht, është dhe anëtar bordi tek SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. në Kosovë.

Përpos ekspertizës, Z. Elvis Ponari ka qenë lektor në trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të rrezikut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit në universitete dhe në institucione financiare vendase dhe të huaja. Z. Elvis Ponari, nuk është palë e lidhur me asnjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Administrimit.

STRUKTURA E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

Fondi SIGAL INVEST administrohet nga SIGAL UNIQA INVEST - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Për kryerjen e misionit të saj konform dispozitave ligjore, shoqëria administruese ka krijuar strukturat e saj.

Krijimi i strukturës organizative mbështetet në funksionet që ajo ka sipas statutit dhe licencës së marrë si dhe të nevojës për përmbushjen e misionit të saj.

Struktura Organizative paraqitet sipas një ORGANIGRAME të përshkruar në vijim:



Administrator i Shoqërisë Administruese është Z. Elvis Ponari, i emëruar nga Këshilli i Administrimit dhe i miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare, deri më 20/06/2026, me të drejtë rinovimi.

Administratori i shoqërisë administruese është person fizik me përgjegjësi drejtuese dhe administruese:

- përfaqëson shoqërinë administruese
- organizon dhe menaxhon veprimtarinë e shoqërisë
- përgatit rregulloret e përgjithshme si dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë administruese sipas ligjit në fuqi dhe i propozon për miratim këshillit të administrimit
- vendos mbi të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që kanë punonjësit dhe kryen aktivitete të ndryshme të përcaktuara në ligj

Për funksionimin e Fondit të Investimit SIGAL INVEST, Shoqëria Administruese ka miratuar dhe stafin zbatues, të përqendruar në Departamente: Departamenti i Përfitimeve të Fondeve të Pensionit, Departamenti i Kontributeve të Fondeve të Pensionit, Departamenti i Menaxhimit të Portofolit, Departamenti i Administrimit të Rrezikut, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Departamenti i Shitjeve dhe Departamenti Ligjor, Burime njerëzore Përputhshmërisë dhe PPP & Financimit të Terrorizmit.

& Përputhshmërisë.

Shoqëria administruese ka krijuar edhe strukturat e veta të përbëra nga Degët në Korçë dhe Shkodër. Gjithashtu, shoqëria administruese përfaqësohet nga degët dhe agjencitë e kompanisë së sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a. bazuar në kontratën e shërbimit midis tyre.

Personeli Kyç:

Z. Elvis PONARI – Drejtor, Drejtorja e Menaxhimit të Portofolit Administrimit të Investimeve

Z. Fation CEKA – Drejtor, Drejtorja e Menaxhimit të Rrezikut

Znj. Livja GJIKA – Drejtore, Drejtorja Ligjore, Burime Njerëzore, Përputhshmërisë dhe PPP & Financimit të Terrorizmit.

Asnjë nga personat e Personelit Kyç nuk është drejtor i një shoqërie tjetër në grupin financiar ose në shoqërinë mëmë.

Funksionet e deleguara:

Shoqëria administruese ka deleguar disa funksione bazuar në një marrëveshje me kompaninë mëmë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. Kompania SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. aktivitetin e saj kryesor e ushtron në fushën e sigurimeve, dëmeve dhe ri-sigurimeve, në përputhje me ligjin “Për veprimtaritë e sigurimit, të ri-sigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe ri-sigurime” si dhe çdo objekt tjetër të lejuar nga legjislacioni dhe që nuk vjen në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve, si më poshtë:

- Shërbimet e marketingut dhe reklamës
- Shërbimet e Informacionit e Teknologjisë
- Shërbimet e Statistikë –Aktuaristikë
- Shërbimet e Auditit të brendshëm dhe të kontrollit të brendshëm
- Konsulencë ligjore
- Kanalet dhe pikat për shitjet e produkteve
- Shërbimet e trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve të specialistëve

Shoqëria administruese mban përgjegjësi të plotë për përmbushjen dhe mbarëvajtjen e çdo funksioni të deleguar.

Konflikti i interesit nga delegimi i funksioneve

Shoqëria administruese vendos të delegojë disa funksione të aktivitetit të saj në palë të treta duke vënë në plan të parë interesin më të mirë të anëtarëve, kjo edhe në rastin kur palë e tretë është shoqëria mëmë.

Çdo palë e tretë që merr përsipër kryerjen e disa funksioneve të deleguara nga shoqëria administruese, është e detyruar të:

- ndërmarrë masat e nevojshme për identifikimin e konflikteve të interesit;
- hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për të shmangur konfliktet e identifikuar të interesit;
- njoftojë shoqërinë administruese për çdo konflikt interesash që nuk mund të shmanget.

Për çdo funksion të deleguar informohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në çdo rast, Shoqëria Administruese do të vazhdojë të jetë përgjegjëse edhe për funksionet e deleguara sipas kërkesave të Ligjit 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, ligjit 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe rregulloreve në zbatim të tyre.

Konflikti i interesit nga delegimi i funksioneve

Shoqëria administruese vendos të delegojë disa funksione të aktivitetit të saj në palë të treta duke vënë në plan të parë interesin më të mirë të investitorëve, kjo edhe në rastin kur palë e tretë është shoqëria mëmë.

Çdo palë e tretë që merr përsipër kryerjen e disa funksioneve të deleguara nga shoqëria administruese, është e detyruar të:

- ndërmarrë masat e nevojshme për identifikimin e konflikteve të interesit;
- hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për të shmangur konfliktet e identifi- kuara të interesit;
- njoftojë shoqërinë administruese për çdo konflikt interesash që nuk mund të shmanget.

Për çdo funksion të deleguar informohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

FONDI I INVESTIMIT SIGAL INVEST

Fondi është licencuar në datë 28/02/2023, ka filluar veprimtarinë e tij në 19/02/2024 për një afat të

pacaktuar. Periudha e ofertës fillestare është 30 ditë. Aktualisht nuk ka të dhëna mbi performancën e fondit në të shkuarën.

Rreziku i investimit në fond i përket tërësisht investitorit.

Kuotat e Fondit janë kuota akumulimi, për të cilat të ardhurat nga investimi ri-investohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave. Fitimi nga investimi në fond reflektohet në rritjen e çmimit të kuotës.

Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave dhe investimi në fond nuk është një investim i garantuar.

Fondi SIGAL INVEST nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve dhe rreziku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

Politika e Investimit

Objektivi i investimit

Objektivi i investimit të Fondit është maksimizimi i kthimit nga investimi nëpërmjet administrimit të aseteve, për një rritje të të ardhurave të investitorit në një periudhë afatmesme duke ruajtur principalin dhe nivelet e mjaftueshme të likuiditetit. Fondi është i përshtatshëm për ata investitorë që janë të gatshëm të ndërmarrin një nivel mesatar rreziku duke investuar në tregun e titujve të borxhit.

Profili i investitorit të synuar

SIGAL INVEST u ofron mundësinë për të investuar në fond çdo individ, personi fizik apo juridik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Investimi në fond shoqërohet me një nivel rreziku mesatar, rrjedhimisht investitorët e synuar duhet të jenë mirë informuar për kushtet dhe karakteristikat e investimeve kolektive.

Fondi është një alternativë e përshtatshme për investitorët të cilët kërkojnë alternativa të tjera investimi të ndryshme nga produktet që ofrohen nga bankat, kanë një tolerancë në nivel mesatar rrezik u dhe rrjedhimisht synojnë përfitim më të lartë. Toleranca e rrezikut ka të bëjë me pranueshmërinë e luhatjeve të mundshme afatshkurtra të çmimit të kuotës.

Shpërndarja strategjike e aseteve

Në përputhje me objektivat e investimit, asetet e fondit do të investohen në kategoritë si më poshtë:

Ekivalentë “cash”-i, transaksione të anasjellta të riblerjes dhe depozita bankare me maturitet deri në 12 muaj; Me qëllim administrimin e likuiditetit afatshkurtër dhe plotësimit ligjor të çdo detyrimi ndaj investitorit, një pjesë e aseteve të Fondit do të mbahen në formën e mjeteve monetare dhe

ekuivalenteve të tyre duke u investuar në instrumenta me likuiditet të lartë si:

Depozita në Lekë me maturim jo më shumë se 1 (një) vit;

- Marrëveshje të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes në institucione të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

- **Tituj borxhi qeveritarë të emetuar ose garantuar nga Republika e Shqipërisë;** Për të arritur objektivin e investimit, Fondi do të investojë më shumë se 35% të vlerës së aseteve në tituj të transferueshëm të lëshuara ose të garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë.

- **Tituj borxhi të emetuara nga organet e Qeverisjes Vendore dhe nga shoqëri tregtare vendase,** që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë; Ndërkohë që një pjesë e aseteve mund të investohen në tituj borxhi të emetuar nga shoqëri tregtare dhe organe vendore, të tregtuara në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë dhe në kuota të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur që funksionojnë në Republikën e Shqipërisë.

- **Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregtohen në tregje të rregulluara, në një shtet të Bashkimit Europian, apo në shtete të lejuara nga AMF;** Për të maksimizuar fitimin, Fondi i Investimit do të investojë 5% të total aseteve në obligacione afatgjatë, dhe duke shfrytëzuar fitimin nga rivlerësimi i kapitalit. Shoqëria do të konkurrojë në mënyrë aktive në ankandet e bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë dhe do të marrë pjesë në tregun sekondar kur kushtet favorizojnë shit-blerjen e një titulli apo për qëllime likuiditeti. E ardhura nga interesi zë pjesën më të madhe të së ardhurës totale duke konsideruar luhatshmërinë e vogël të vlerës së tregut të obligacioneve qeveritare.

- **Kuota të fondeve të investimit me fokus në tituj borxhi të emetuar në monedhën vendase;** Me qëllim të diversifikimit të portofolit, Fondi mund të investojë deri në 5% të aseteve në kuota të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur, të cilat janë të licencuara nga AMF për të ushtruar aktivitetin e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 56/2020 datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. Përzgjedhja e këtyre instrumenteve do të bëhet mbi bazë të kriterëve të likuiditetit, kthimit dhe riskut që mbartin. Investimet do të bëhen në kuota të fondeve, portofolet e aseteve të të cilave kanë risk dhe luhatshmëri të ngjashme me indikatorët e Fondit.

** Në çdo rast, alokimi i investimeve do të sigurojë respektimin e limiteve të vendosura në rregulloret e miratuara nga AMF, për administrimin e likuiditetit të fondit*

Fondi i jep mundësi çdo individi apo institucioni, që ka prioritet sigurinë dhe likuiditetin, të investojë

me një profil risku të ulët. Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë një normë kthimi më të lartë se depozitat bankare, si dhe likuiditetin që i mungon këtyre depozitave, në përputhje me riskun që shoqëron asetet ku do të investohet fondi, që do të jenë kryesisht tituj borxhi të emtuar nga Republika e Shqipërisë. Investimi në Fond i jep mundësi investitorëve të diversifikojnë kapitalin e tyre, dhe të përfitojnë nga riinvestimi profesional i fitimeve të gjeneruara.

Për arritjen e objektivit të investimit, fondi investon deri në 90% të totalit të aseteve në tituj borxhi të emtuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 30% të aseteve në tituj borxhi të emtuara nga organet e qeverisjes vendore dhe nga shoqëri tregtare vendase të tregtuara në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë.

Më shumë se 35% e vlerës së aseteve të fondit mund të investohen në tituj të transferueshëm ose në instrumente të miratuara të tregut të parasë, të lëshuara ose të garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë.

• **Tregjet e synuara nga fondi SIGAL INVEST**

Fondi SIGAL INVEST synon kryesisht investimin në tregun primar të titujve shtetëror, të cilët përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet e emtuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në monedhën lekë. Këto tituj shtetëror përfshijnë instrumente borxhi afatshkurtër, si bonot e thesarit me maturim 3, 6 dhe 12 muaj, si dhe instrumente borxhi afatmesëm, si obligacionet e thesarit. Vëllimet vjetore të emetimit të këtyre titujve variojnë në bazë të nevojave të brendshme të borxhit të shtetit shqiptar dhe publikohen çdo 3 muaj në kalendarin e emetimit.

Bursa Shqiptare e Titujve (ALSE) është një bursë private në Shqipëri, ku tregtohen të gjitha llojet e instrumenteve financiare të njohura nga Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt” (i ndryshuar) dhe që përmbushin kriteret e listimit të përcaktuara nga ALSE. Kjo bursë ofron një treg sekondar të rregulluar për Tituj të emtuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Që nga shkurti 2019, ALSE ka zgjeruar mundësinë e listimit duke lejuar edhe tituj të tjerë përveç borxhit të qeverisë, duke hapur kështu rrugën për listimin e titujve të emtuar nga korporatat shqiptare.

Sipas Ligjit Nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, tregjet mbi banak të titujve të emtuar dhe garantuar nga Qeveria qendrore e Republikës së Shqipërisë janë tregje të rregulluara, me kusht që shitja të jetë e njohur dhe e rregulluar nga autoriteti kompetent dhe të jetë e hapur për publikun.

Fondi është në monedhën Lekë. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Lekë.


Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik më i Ulët

Përfitime Tipike më të Ulta

Rrezik më i Lartë

Përfitime Tipike më të Larta



FONDI I INVESTIMIT SIGAL INVEST

Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Kategoria më e ulët nuk do të thotë se investimi është pa risk. Për Sigal Invest kategoria e parashikuar e treguesit të rrezikut dhe përfitimit vlerësohet në nivelin 3, bazuar në politikën e investimit të Fondit SIGAL INVEST. Kjo kategori vlerësohet nga të dhëna historike e tipologjike të bazuara tek volatiliteti i 5 viteve të fundit të tregut të obligacioneve në të cilin fondi planifikon të investojë në vijim.

Megjithatë, duke qenë se ecuria e kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të Letrave me Vlerë të Qeverisë (të cilat në vetvete kanë luhatshmëri relativisht të ulët), parashikimet për të ardhmen janë gjithsesi për ndryshime relativisht të ulta të profilit të riskut.

Instrument financiar	Shpërndarja strategjike
Tituj të emetuar ose garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë	Deri në 90%
Depozita bankare, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, marrëveshje të anasjellta të riblerjes	Deri në 10%
Tituj borxhi të emetuara nga organet e qeverisjes vendore dhe nga shoqëri tregtare vendase të tregtuara në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë	Deri në 30%
Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregtohen në tregje të rregulluara, në një shtet të Bashkimit Europian, apo në shtete të lejuara nga AMF	Deri në 5%
Kuota të Fondeve të Investimit	Deri në 5%

Shoqëria Administruese ka qëllim të ruajë dhe mbrojë kapitalin e investitorit. Fondi synon të sigurojë përfitueshmëri nga investimi duke marrë në konsideratë kushtet e tregut, shpërndarjen strategjike të portofolit të investimit, kohëzgjatjen mesatare dhe risqet me të cilat përballlet.

Megjithatë, duke marrë parasysh të gjithë faktorët e rrezikut të përfshirë në këtë marrëdhënie, kapitali i investitorit mund të jetë i rrezikuar edhe pse Fondi investon kryesisht në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare të cilat gëzojnë një profil rreziku të ulët.

Kushtet e tregut mund të ndikojnë në luhatjen e ecurisë së Fondit dhe në vlerën e investimit. Duke marrë parasysh që ekzistojnë një sërë faktorësh që mund të ndikojnë tek ecuria e Fondit, Shoqëria Administruese do të synojë arritjen e një performancë të lartë përfitueshmërie për investitorët, por nuk mund ta garantojë atë.

Duke marrë parasysh sa më lart, si dhe kohën e nevojshme që duhet për zbatueshmërinë sa më të përshtatshme të politikave të investimit në mënyrë që të synohet (por jo të garantohet) maksimizimi i kthimit, rekomandohet që periudha minimale e qëndrimit në fond të jetë 2 vjet.

Një ndër treguesit që merret në konsideratë në vendimin për investim është kohëzgjatja e modifikuar e portofolit e cila i referohet mesatares së ponderuar të treguesve të ndjeshmërisë së çmimit të letrave me vlerë individuale që përbëjnë portofolin e investimeve.

Bazuar në Politikën e Investimit e cila do të rishikohet çdo vit, në varësi të kushteve të tregut, shpërndarja strategjike e aseteve mund të ndryshojë. Kjo shpërndarje strategjike shërben si orientim për investitorin ku fondi synon të investojë brenda limiteve të përcaktuara më lart sipas instrumentave financiare.

Fondi investon në tituj borxhi si obligacione, të cilat emetohen ose garantohen nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga AMF.

Informacion mbi Tregjet e Investimit

Fondi do të investojë në tregjet e rregulluara dhe jo të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht në tregun ALSE për tregjet e rregulluara dhe tregjet OTC për ato jo të rregulluara. Po ashtu, investimet do të përfshijnë tregje të tjera ndërkombëtare, të rregulluara ose të pasigurta, në përputhje me strategjinë e investimit dhe rregulloret përkatëse të AMF-së.

- Tregje të Rregulluara: Fondi do të investojë në tituj të transferueshëm dhe instrumente të borxhit që tregtohen në tregje të rregulluara në shtete të BE-së dhe në shtete të tjera të lejuara nga AMF. Këto përfshijnë aksione dhe obligacione që janë listuar dhe tregtohen në tregje si Frankfurt Stock Exchange, London Stock Exchange, dhe të tjera tregje të miratuara.

- Tituj: Investimet përfshijnë aksione dhe obligacione të listuara në tregje të rregulluara, me fokus në tituj të emetuar nga qeveri dhe kompani të sigurta në BE dhe vende të tjera të miratuara.

- Pjesëmarrja Aktivë në Tregje: Pjesëmarrja aktive në tregjet primare dhe sekondare do të përfshijë tregjet në Republikën e Shqipërisë dhe tituj të emetuar ose garantuar nga Republika e Shqipërisë. Kjo përfshin aktivitetet e blerjes dhe shitjes në këto tregje lokale

Fondi gjithashtu, mund të investojë në obligacione të emetuara nga institucionet ndërkombëtare dhe / ose shoqëri tregtare, që tregtohen në një treg të rregulluar ose bursë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në një vend të BE-së ose në një vend tjetër të lejuar nga AMF dhe në kuota të fondeve të tjera të investimit, fokusi i të cilave janë titujt e borxhit.

Fondi mund të investojë deri në 90% të asetëve të tij në tituj të emetuar ose të garantuar nga Republika e Shqipërisë. Maturitetet në këto tituj do të shkallëzohen aq sa të jetë e mundur.

Një pjesë e asetëve mbahet në cash apo ekuivalentë të tij, transaksione të marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes dhe depozita bankare me maturim deri në një vit. Qëllimi i përdorimit të investimeve në tregun e parasë si instrumenta për qëllime të menaxhimit të likuiditetit, si depozita dhe transaksione të marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes është të mbulojë nevojat e likuiditetit afatshkurtër të Fondit duke përbushur edhe detyrimet ligjore ndaj investitorëve brenda afateve të përcaktuara.

Fondi mund të investojë deri në 5% të asetëve në kuota të fondeve të investimit, të cilat janë të licencuara nga AMF për të ushtruar aktivitetin e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 56/2020 datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Përzgjedhja e këtyre instrumenteve do të bëhet mbi bazë të kriterëve të likuiditetit, kthimit dhe rrezikut që mbartin.

Investimet do të bëhen në kuota të fondeve, portofolet e asetëve të të cilave kanë rrezik dhe luhatshmëri të ngjashme me indikatorët e Fondit.

Investimet e lejuara

Sipërmarrja e Investimeve Kolektive me ofertë publike investon në aktivet e përcaktuara si të lejuara nga AMF në referencë të nenit 139 të ligjit 56/2020 datë 30/04/2020, të inkuadruara përkatësisht edhe në rregulloret e brendshme, si më poshtë:

Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, të pranuar ose të tregtuara në një treg të rregulluar të licencuar, të njohur ose të miratuar nga AMF me aktet rregullatore, si edhe tituj të emetuar dhe të garantuar nga Qeveria Qendrore e Republikës së Shqipërisë;

Tituj të transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të pranuar në listën zyrtare në një treg të rregulluar në një vend anëtar të BE-së ose në tregun e rregulluar të një vendi tjetër, i cili është i rregulluar, vepron rregullisht dhe është i njohur dhe i hapur për publikun dhe është i miratuar nga AMF, me kusht që përzgjedhja e tregut të rregulluar të jetë parashikuar në aktin themelues dhe këtë prospekt;

Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë të sapo emetuara, kur kushtet e emetimit parashikojnë paraqitjen e një kërkesë për pranim në listën zyrtare të një burse ose një tregu tjetër të rregulluar që ushtron aktivitet rregullisht dhe njihet dhe është i hapur për publikun, të një vendi anëtar të BE-së ose në çdo vend tjetër të miratuar nga AMF, me kusht që përzgjedhja e tregut të rregulluar të jetë parashikuar në aktin themelues dhe këtë prospekt dhe që pranimi të jetë siguruar brenda një viti pas emetimit;

ç) Sipërmarrje të investimeve kolektive me

pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, përfshirë sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm.

Depozita bankare të pagueshme, sipas kërkesës ose që mund të tërhiqen dhe që maturohen brenda 12 muajve, me kusht që selia e regjistruar e bankës të ndodhet në një vend tjetër, në të cilin aplikohen rregullat e mbikëqyrjes prudenciale, që konsiderohen nga AMF si të barasvlershme me ato të parashikuara në ligjin 56/2020 dt. 30/04/2020;

dh) Instrumente të tregut të parasë, përveç atyre që tregtohen në një treg të rregulluar, të cilat përmbushin kërkesat e AMF-së mbi likuiditetin dhe kanë një vlerë që mund të përcaktohet me saktësi në çdo moment, nëse emetimi ose emetuesi i këtyre instrumenteve në vetvete është i rregulluar, me qëllim mbrojtjen e investitorëve dhe të kursimeve dhe me kusht që këto investime:

i. Të emetohen dhe të garantohen nga një autoritet qendror, rajonal ose vendor ose nga një bankë qendrore e një vendi anëtar të Bashkimit Europian, Banka Qendrore Europiane, Bashkimi Europian ose Banka Europiane e Investimeve, një vend tjetër ose, në rastin e një vendi federal, nga një prej qeverive anëtare të federatës ose nga një organizatë publike ndërkombëtare, së cilës i përkasin një a më shumë vende anëtare; ose ii. të jenë emetuar nga një subjekt, titujt e të cilit tregtohen në tregje të rregulluara; ose iii. të jenë emetuar ose garantuar nga një subjekt që është objekt i mbikëqyrjes prudenciale, që konsiderohet nga AMF e barasvlershme me atë të parashikuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë; ose iv. të jenë emetuar nga organe të tjera që u përkasin kategorive të miratuara nga AMF, me kusht që investimet në instrumente të tilla të jenë objekt i mbrojtjes së investitorëve, që është e barasvlershme me atë të parashikuar në nënndarjet “i”, “ii” dhe “iii”, të kësaj shkronje, dhe me kusht që emetuesi të jetë shoqëri tregtare, kapitali dhe rezervat e së cilës janë të paktën, 1 300 000 000 (një miliard e treqind milionë) lekë dhe që harton dhe publikon raportin vjetor e pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Gjithashtu, mund të jetë një subjekt i cili, brenda një grupi shoqërisht që përfshin një ose disa shoqëri të listuara në bursë, funksionon vetëm për financimin e grupit ose mund të jetë një subjekt që funksionon vetëm për financimin e mekanizmave të titullimit që përfitojnë nga një linjë likuiditeti bankare; ose

Tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, të emetuara në Republikën e Shqipërisë dhe të njohura nga AMF si të pranuar ose të tregtuara në një treg të rregulluar.

ë) Kuota të fondeve të investimeve me ofertë publike ose aksione të shoqërive të investimeve me ofertë publike të rregulluara me këtë ligj; ose

Depozita në banka, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat mund të tërhiqen menjëherë dhe që kanë afat maturimi, jo më shumë se 12 muaj; ose

Instrumente financiare derivative dhe kontrata private të së ardhmes (forward), siç lejohet me rregullore nga AMF; ose

gj) instrumente të tregut të parasë, përveç atyre të tregtuara në një treg të rregulluar, siç lejohet me akt nënligjor nga AMF; ose

Mjete monetare dhe depozita pa afat.

Vendet e Ekzekutimit

Vendet e ekzekutimit që mundësojnë Ekzekutimin më të Mirë për secilin Instrument Financiar në mënyrë të qëndrueshme, renditen si më poshtë:

Tregjet e rregulluara vendase dhe ndërkombëtare të lejuara nga legjislacioni lokal

Tregjet e rregulluara i nënshtrohen rregullave të rrepta të funksionimit, të rregulluara nga organi rregullator përkatës në secilin juridiksion në të cilin ata veprojnë. Tregu i titujve, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë rregullohet me legjislacionin shqiptar. Për këto tituj, transaksionet bëhen me palë të pranueshme në tregun sekondar dhe përmes pjesëmarrjes direkt në

tregun primar.

Tregu mbi Banak (Over the Counter)

Tregjet financiare të organizuara në formën e Tregut mbi banak (OTC) përdoren kryesisht për produkte me të ardhura fikse. Sipas llojit të instrumenteve, transaksionet për obligacionet dhe Fondet e tregtuara në bursë zakonisht kryhen përmes platformave të besueshme të tregtimit si Bloomberg dhe Refinitiv ose direkt me palën.

Norma e interesit / çmimi është kriteri kryesor për transaksionet e kryera përmes platformave të tregtimit. Normalisht faktorët e ekzekutimit renditen si më poshtë:

1. Norma e interesit / çmimi
2. Shpejtësia e ekzekutimit
3. Mundësia e ekzekutimit dhe procesi i shlyerjes
4. Natyra / madhësia e transaksionit
5. Tarifat / kostot

Një diferencim themelor mund të bëhet për sa i përket strukturimit të likuiditetit të këtyre instrumenteve individuale. Nëse likuiditeti është relativisht i lartë, kriteret tilla si norma e interesit / çmimi dhe shpejtësia e ekzekutimit marrin një vlerë më të lartë. Nëse likuiditeti është më i ulët, më shumë peshë i jepet llojit të urdhërit, si dhe mundësisë së ekzekutimit dhe përmbylljes së tij.

Për instrumentet e tregut të parasë siç janë depozitat, transaksione të Marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të Riblerjes (repo / reverse repo), renditja e mëposhtme e faktorëve të ekzekutimit konsiderohet kur vendoset për një palë:

1. Norma e interesit
2. Vlerësimi i kreditit së Palës

3. Mundësia e ekzekutimit dhe procesi i shlyerjes

4. Natyra / madhësia e transaksionit

5. Tarifat / kostot

Për investime në SIK të tjera dhe shlyerjen e kuotave të fondeve në rast të investimeve në SIK të tjera, transaksionet kryhen përmes Abi Bank në cilësinë e saj si Banka Depozitare

Transaksionet e ri financimit të titujve

Shoqëria Administruese kur e gjykon të arsyeshme dhe në përputhje me politikën e investimit do të përdorë marrëveshjet e anasjellta të riblerjes, për një menaxhim eficient të likuiditetit si edhe për të reduktuar rrezikun e kreditit të kundërpartisë. Një marrëveshje e anasjellte e riblerjes nënkupton blerjen e titujve me kushtin për t'i rishitur ato me një çmim të paracaktuar në një datë të ardhshme.

Në një marrëveshje të anasjellte riblerje nëse shitësi i titujve do të falimentonte dhe çmimi i tregut të titujve të blerë do të binte poshtë nivelit të shumës së paguar nga fondi në momentin fillestar, atëherë fondi do të pësonte humbje, të barabartë me diferencën e çmimit të shitjes së titujve në treg me shumën e paguar në momentin fillestar.

Në transaksionet e marrëveshjeve të Riblerjes / të anasjellte të riblerjes përdoren si kolateral tituj të transferueshëm, të tregtueshëm në tregje të rregulluara dhe që konsiderohen Asetet likuide të cilësisë së lartë.

Përdorimi i marrëveshjeve të Riblerjes / të anasjellte të riblerjes mund të shoqërohet me rreziqe të tillë si rrezik i palës tjetër që nuk shlyen detyrimet në kohë, rrezik i tregut për shkak të ndryshimit që mund të pësojë vlera e kolateralit, rrezik i kredisë në lidhje me kolateralin. Për tu mbrojtur nga rreziku i palës tjetër do të zbatohen kushtet e marrëveshjes së nënshkruar.

Faktorët e rrezikut

Informacion i përgjithshëm

Investimi në instrumente financiare përfshin sipërmarrjen e rrezikut. Nëpërmjet përcaktimit të procedurave të administrimit të rrezikut dhe sistemit të brendshëm, shoqëria administruese është në gjendje të bëjë identifikimin, matjen si dhe administrimin e rrezikut.

Shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative Njësinë e Administrimit të Rrezikut, e cila funksionon në mënyrë të pavarur nga njësitë operationale në mënyrë që të garantohet shmangia e konfliktit të interesit dhe efica e procesit të administrimit të risqeve në vazhdimësi. Rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht, por mund të reduktohet duke zbatuar procedurat e përshtatshme për administrimin e tij. Për këtë qëllim, shoqëria administruese ka evidentuar risqet potenciale ndaj të cilave investitori mund të ekspozohet dhe që mund të ndikojnë në performancën e Fondit.

Risqet e lidhura me investimin

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes nga luhajtjet në vlerën e tregut të pozicioneve të portofolit të fondit që lidhen me ndryshimet në variablat e tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e aksioneve dhe të mallrave. Rreziku i tregut përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi vlerën e asetëve të Fondit, për shkak të ndryshimeve të tregut. Risqet kryesore që klasifikohen në kategorinë e rrezikut të tregut:

Rreziku i normave të interesit është rrezik u i humbjes nga luhajtjet e normave të interesit dhe efekti i tyre në vlerën e aktiveve të fondit. Vlera e asetëve të Fondit ndikohet nga ndryshimi i normave të interesit të titujve në të cilat Fondi ka investuar. Rreziku i normave të interesit lidhet me ndryshimin e tyre në kah të papërshtatshëm dhe me ndryshimin e nivelit të luhatshmërisë së tyre.

Rreziku i kursit të këmbimit valutor është rrezik u i humbjes nga ndryshimet e kurseve të këmbimit dhe efekti i tyre në vlerën e aktiveve të fondit, në rast se aktivet e fondit investohen në një monedhë të ndryshme nga monedha e përdorur për të llogaritur kthimin nga investimi;

Rreziku i Inflacionit - Rreziku i inflacionit përfaqëson mundësinë që vlera reale e investimit të rezultojë më e ulët për shkak të rritjes së çmimeve.

Njësia matëse e rrezikut të tregut të lidhur me lëvizjen e normave të interesit është “Kohëzgjatja e modifikuar” e cila mat ndjeshmërinë e lëvizjes së çmimit të titullit në portofolin e fondit në raport me lëvizjen e normave të interesit. Kohëzgjatja e modifikuar është e lidhur ngushtë me maturitetin e titujve në portofolin e fondit. Sa më i lartë të jetë ky tregues “Kohëzgjatja e modifikuar” aq më e lartë do të jetë edhe ndjeshmëria e fondit ndaj lëvizjes së normave të interesit.

Shoqëria administruese do bëjë diversifikim të portofolit sipas llojit të instrumentit financiar, emetuesit, maturitetit, monedhës, si edhe diversifikimin gjeografik në përputhje me politikat e investimit dhe rregulloreve.

Shoqëria administruese do të kryejë një kontroll cilësor dhe sasior të rrezikut të tregut në mënyrë të vazhdueshme, që të reduktojë maksimalisht pasojat negative të tij mbi asetet e Fondit të Investimit.

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare nga pamundësia që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e aktiveve të fondit, të përmbushë pjesërisht apo plotësisht detyrimet e tij sipas kushteve të pranuar. Ndikimi i përkeqësimit të aftësisë paguese të emetuesit reflektohet në uljen e çmimit të instrumentave financiare, duke e përcjellë këtë ndikim në ulje të vlerës neto të aseteve të Fondit. Shoqëria Administruese ka adaptuar një administrim të kujdesshëm dhe konservator të aseteve të Fondit bazuar në politikën e investimit. Fondi konsideron te gjithë elementet e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë, për qëllime të administrimit të rrezikut të kredisë

Rreziku i likuiditetit është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së likuiditetit, rreziku i humbjes kur një pozicion aktiv në portofolin e fondit nuk mund të shitet, likuidohet apo mbyllet me kosto sa më të ulët brenda një harku kohor mjaftueshmërisht të shkurtër, duke vënë

në rrezik në këtë mënyrë aftësinë e fondit për të përmbushur detyrimet e tij për shlyerje, të përcaktuara në prospekt.

Shoqëria Administruese do të respektojë në çdo kohë kërkesat e AMF në lidhje me mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të aktiveve likuide me cilësi të lartë (ALCL) në përputhje të Ligjit 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” si dhe të rregulloreve mbështetëse në zbatim të tij.

- 10% të aseteve neto të fondit; ose
 - Vlera bruto e flukseve dalëse kumulative të tre muajve të fundit deri në datën e llogaritjes, e cila duhet të jetë e përditësuar (flukset hyrëse nuk zbriten për qëllimet e llogaritjes së flukseve dalëse).
- Shoqëria Administruese do të zbatojë në mënyrë rigoroze rregulloren nr. 106, datë 30/06/2021 “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të licencuara të investimeve kolektive me ofertë publike”.

Rreziku i palës tjetër ose palës së lidhur është rrezik u që lind nga mos përmbushja e detyrimeve kontraktuale nga pala tjetër ose pala e lidhur e shoqërisë administruese.

Shoqëria Administruese në emër të Fondit kryen transaksione ose transferta me palë të tjera, të cilat mund të mos kryhen apo të kryhen me vonesë si pasojë e mos zbatimit të kushteve të marrëveshjes mes palëve.

Rreziku i përballjes me shlyerje në shuma të mëdha- Në bazë të madhësisë së shumës së kërkuar për shlyerje (gjithnjë e vënë përballë madhësisë së aseteve të Fondit), Fondi mund të vendoset përballë faktit të likuidimit, të pjesshëm e proporcional me kërkesat për shlyerje, në mënyrë të menjëhershme nga portofoli i aseteve të tij. Ky mund të ketë një efekt negativ në performancën e Fondit, sepse shitja e detyruar dhe e paparashikuar e një instrumenti financiar në mënyrë të parakohshme, mund të rezultojë në rënie të çmimit të kuotës.

Rreziku i përqendrimit është rreziku i humbjes nga përqendrimi i aktiveve të fondit në një emetues, në një grup emetuesish që janë palë të lidhura, në emetues që janë në një zonë të caktuar gjeografike, apo në emetues që përfshihen në një sektor të caktuar të ekonomisë.

Shoqëria administruese ndërton një portofol të aseteve bazuar në strategjinë e diversifikimit të miratuar, në përputhje me dispozitat e ligjit për investime e lejuara dhe kufizimet mbi ekspozimet maksimale të parashikuara në ligj dhe aktet rregullative të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Rreziku i performancës -Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

volatilitetit të çmimit të tregut të kapitalit.

Risku i kapitalit është risku i humbjes nga ndryshimet e çmimit të instrumenteve të kapitalit dhe efekti i tyre në vlerën e aktivitetit të një fondi. Gjatë periudhës së investimit, investuesi vendoset përballë me mundësinë që investimi i bërë mund të mos japë kthimin e parashikuar duke reflektuar luhatshmërinë e aseteve, detyrimeve dhe instrumentave financiare kundrejt volatilitetit të çmimit të tregut të kapitalit.

Risqet e lidhura me shoqërinë administruese

Rreziku operacional është rreziku i humbjes që vjen si pasojë e procedurave të brendshme të papërshtatshme, nga mosfunksionimi në lidhje me sistemet dhe stafin e shoqërisë administruese ose palës së lidhur e cila kryen disa funksione të deleguara për shoqërinë administruese, ose që rezulton nga ngjarje të jashtme dhe që përfshin risqe ligjore, risqe dokumentacioni dhe risqe që rezultojnë nga procedurat e tregtimit, shlyerjes dhe vlerësimit, të cilat zbatohen nga fondi.

Në mënyrë që të minimizohet rrezik u operacional, shoqëria administruese zhvillon sisteme të përshtatshme kontrolli të brendshme dhe përcakton saktësisht procedurat dhe rregulloret për të gjithë punonjësit në të gjitha fushat e operacioneve, si dhe në rast eventesh të jashtme.

Shoqëria administruese duhet të zbusë rrezikun operacional duke ndërmarrë, ndër të tjera, veprimet si:

- Miratimin e metodave dhe procedurave për administrimin e rrezikut operacional;
- Identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut operacional.

Rreziku reputacional është rrezik u i dëmtimit të besueshmërisë së shoqërisë administruese në tregun ku kryen veprimtarinë e saj, duke përfshirë impaktin e ngjarjeve specifike të cilat mund të përkeqësojnë apo ndikojnë negativisht perceptimin e publikut për shoqërinë administruese.

Rrezik u i reputacionit përfaqëson potencialin për një dëmtim të imazhit si rrjedhojë e perceptimit negativ nga grupet e interesit/publiku për Fondin lidhur me veprime ose mosveprime të Shoqërisë Administruese dhe punonjësve të saj, ngjarje të cilat perceptohen si të papërshtatshme dhe jo-konsistente me vlerat e Fondit.

Shoqëria Administruese ka ndërtuar modelin e biznesit të bazuar në besimin e publikut dhe ka krijuar standarde të qëndrueshme për identifikimin dhe vlerësimin e ngjarjeve që mund ta dëmtojnë atë, duke u kujdesur për zbatimin e rregullave dhe sigurimin e transparencës me investitorët e Fondit.

Rreziku i përputhshmërisë përfaqëson probabilitetin e krijimit të efekteve negative mbi pozicionin e shoqërisë administruese për shkak të mos-zbatimit të rregulloreve, kryesisht të atyre që rregullojnë nivelin e saj të kapitalit dhe parandalimin e pastrimit të parave.

Shoqëria Administruese kryen rregullisht vlerësimin e asetëve, humbjeve të mundshme dhe mundësisë së rritjes së kapitalit, siguron që kapitali të jetë në nivelin minimal të kërkuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe përcakton procedurat e identifikimit dhe parandalimit të pastrimit të parave.

Rreziku i personave dhe personelit kyç i referohet aftësive profesionale të personave dhe personelit kyç të shoqërisë administruese të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm në performancën e fondit duke përfshirë veprimet dhe vendimmarrjen e anëtarëve të Këshillit Administrimit dhe menaxherëve të fondit.

-Risqet që ndikojnë tek investitorët dhe shoqëria administruese

Rrezik u Ligjor është rreziku i humbjeve financiare që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë. Interpretimet e ndryshme të ligjeve nga autoritetet tatimore dhe gjykatat nuk mund të përjashtohen.

Reziku i Kreditit

është rreziku i humbjes financiare për Fondin nëse një palë e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Fondi merr në konsideratë këto elemente të ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit (si rreziku Individual i mospagimit dhe rreziku i sektorit).

Këshilli Administrativ i Fondit ia ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut kreditor drejtuesve të shoqërisë Administruese, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e rrezikut të kreditit të Fondit. Investimet e Fondit janë në obligacione të Qeverisë së Shqipërisë, ndërsa paratë dhe ekuivalentët e saj janë pranë depozitarit.

Reziku politik lidhet me mundësinë që ndryshime apo ngjarje të rëndësishme politike mund të kenë një ndikim material në mjedisin ekonomik të vendit. Ndryshime të tilla mund të çojnë në vështirësi paguese të Qeverisë Shqiptare, të cilat pasqyrohen në uljen e vlerës së instrumentave financiarë të emetuara dhe për pasojë në vlerën neto të aseteve të Fondit.

Reziku Rregullator - i referohet rrezikut që rezulton nga ndryshime të mundshme në legjislacion i cili rregullon veprimtarinë e Fondit dhe investimet në Fond. Masa shtrënguese shtesë të cilat mund të aplikohen si rezultat i ndryshimeve rregullative apo fiskale mund të kenë ndikim negativ në vlerën e aseteve të fondit.

Reziku i depozitarit- Funkzioni i depozitarit duhet të mbulohet nga një institucion bankar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në rast se, për një arsye apo një tjetër, ky institucion nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ligjore, disa aktivitete të fondit, si për shembull përlllogaritja e vlerës neto të aseteve apo procesit të investimit, mund të vonohen.

Reziku i agjencisë është rrezik u që personat dhe/ose personeli kyç i shoqërisë administruese të përdorin autoritetin e tyre për të përfituar individualisht dhe nuk veprojnë në të mirë të investitorëve të fondit apo në interes të aksionarëve.

Rrezik u i agjencisë është i lidhur me probabilitetin e ngjarjeve që përfshijnë ndërmarrjen e veprimeve apo përdorimin e autoritetit në përfitim individual kundrejt përfitimit të Fondit. Shoqëria Administruese ka implementuar mekanizma kontraktuale dhe të kontrollit për mirëfunksionimin e Shoqërisë Administruese dhe të Fondit, duke siguruar integritetin në të gjitha proceset në përputhje me ligjet, rregullat dhe mbrojtjen e aseteve të Fondit.

Reziku që vjen nga pezullimi i shitjes/ shlyerjes së kuotave Si rregull, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerje të kuotave të Fondit. Nga ana tjetër e duke gjykuar në varësi të situatës dhe të momentit, shoqëria administruese mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave, sipas parashikimeve të ligjit 56/2020 datë 30/04/2020.

Ky pezullim mund të kërkojë nëse ka arsye për të besuar se kjo është e nevojshme në interes të mbrojtjes së publikut ose të mbajtësve të kuotave ose në rastet e forcës madhore.

AMF nga ana e saj mund vlerësojë apo konsiderojë se Fondi ndodhet në situatën ku ka shkaqe të forta dhe të mirë-justifikuara që të urdhërojë Shoqërinë Administruese dhe Depozitarin të pezullojë përkohësisht shitjet dhe shlyerjet, në mbrojtje të interesave të mbajtësve ekzistues ose potencial të kuotave.

Reziku nga funksionet e deleguara - Shoqëria administruese mund të delegojë disa funksione, si për shembull shitja e fondit, tek palët të treta të cilat mund të gjenerojnë rrezik . Përgjegjësia ligjore për funksionet e deleguara i takon

shoqërisë administruese.

Rreziku i vlerësimit të Aseteve

Në tregjet joaktive, mungesa e kërkesës dhe ofertës të vazhdueshme bën që vlerësimi i asetëve të kryhet përmes modeleve (mark-to-model), të cilat mund të mos jenë plotësisht të sakta. Ndërkohë, në tregjet aktive, vlerësimi i asetëve bazohet në çmimet e tregut në përmbylljen e ditës. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se luhatshmëria e çmimeve nuk ndodh vetëm në raste krizash; ndodhin variacione të mëdha në çmimet e titujve edhe në periudha të tjera, dhe çmimi i shitjes mund të ndryshojë nga çmimi i vlerësimit në momentin e transaksionit.

Rreziku i ngjarjes është rrezik u i humbjes nga rrethana të paparashikueshme që shkaktojnë rënien e vlerës së tregut të një instrumenti financiar në mënyrë të menjëhershme ose të papritur në krahasim me sjelljen e tregut në përgjithësi dhe në një mënyrë që tejkalon shkallën normale të luhatjeve në vlerën e tregut.

Risku i vendit është rreziku i humbjes kur një autoritet përkatës apo bankë qendrore e një vendi nuk mund të përmbushë ose pritët të mos përmbushë detyrimet kundrejt subjekteve jo

rezidente, si dhe kur debitorët e tjerë, rezidentë të atij vendi, për shkak të rezidencës së tyre, nuk mund të përmbushin detyrimet e tyre kundrejt subjekteve jo rezidente.

Në rastin e Fondit të Investimeve, duke qenë se fondi ushtron aktivitetin e tij në Shqipëri dhe investitorët presupozohet të jenë rezidentë, risku i vendit lidhet me aftësinë paguese të Republikës së Shqipërisë. Nëse Republika e Shqipërisë përballet me vështirësi financiare ose aftësia e saj paguese dobësohet, kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e investimeve të fondit dhe në aftësinë për të realizuar kthime të pritshme.

Rreziku i situatave të jashtëzakonshme dhe ndikimi i forcave madhore është mundësia e ndikimit në gjendjen financiare të një ngjarje natyrore ose shoqërore të tilla si termet, permbytje, zjarr, situata pandemike, lufta, apo kriza të theksuara ekonomike mund të ndikojnë në kthimin e aktiveve të fondit. Keto situata pengojnë Fondin të realizojë objektivat e të përmbushi detyrimet, dhe që nuk ndodhin për faj të tij e nuk mund të shmangen prej tij, pavaresisht kujdesit të treguar.

SHUMA MINIMALE E INVESTIMIT DHE VLERA FILLESTARE E KUOTËS

Kuotat në Fond janë të emetuara në Lekë. Shuma minimale e investimit në Fond është 10,000 Lekë. Vlera minimale e llogarisë për qëndrimin në Fond është 10,000 Lekë. Nëse balanca e llogarisë mbetet më e vogël se 10,000 Lekë, llogaria mund të mbyllet. Në këtë rast, kuotat do të shlyhen me çmimin e aplikueshëm në ditën e mbylljes.

Gjatë periudhës së ofertës fillestare të Fondit, çmimi i emetimit për kuotë është 1.000 lekë. Periudha e Ofertës Fillestare është 30 ditë. Ajo filloi më 19/01/2024 dhe përfundoi më 17/02/2024.

Shoqëria Administruese nuk ka përcaktuar një shumë limit minimale për ofertën fillestare. Oferta fillestare përfundon sipas afatit të sipërpërmendur dhe nuk ka asnjë rrethanë tjetër që përcakton mbylljen e saj. Pas ofertës fillestare çmimi i kuotës së Fondit është i barabartë me vlerën neto të asetëve për kuotë, i llogaritur në bazë të çmimit të tregut për të gjitha asetet e portofolit të Fondit.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET NGA KUOTAT E FONDIT

Në momentin e blerjes së kuotave, çdo investitor ka të drejtë të kërkojë të pajiset me një certifikatë e cila vërteton pronësinë e tij mbi kuotat e blera. Certifikata e blerjes lëshohet nga Shoqëria Administruese me kërkesë të investitorëve brenda 7 ditëve nga data e marrjes së pagesës së bërë në sipërmarrjen e investimeve kolektive me ofertë publike. Ajo përmban: datën e blerjes së kuotave, emërtimin e fondit, emrin dhe selinë e regjistruar të shoqërisë administruese, numrin e kuotave të blera, emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të kuotave, vendin dhe datën e lëshimit të certifikatës, si dhe nënshkrimin e personit të autorizuar të Shoqërisë Administruese.

Të drejtat që lidhen me pronësinë e kuotave në Fond janë:

- E drejta e informimit (raporte dhe pasqyra financiare gjashtëmujore dhe vjetore);
- E drejta për të marrë pjesë në fitimet e Fondit, më mënyrë të përpjesshme me pjesëmarrjen e investitorit në të;
- E drejta për shlyerjen e kuotave në çdo kohë; E drejta e transferimit të kuotave;
- E drejta që asetet e Fondit, në rast falimenti të shoqërisë administruese, të jenë objekt i së drejtës së ndarjes.

Lidhur me detyrimet për pronësinë e kuotave në Fond, mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në Fond.

Mbajtësi i kuotave të fondit nuk mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit.

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kuotave të fondit. Depozitari i fondit, me seli në adresën: Rruga e Kavajës Nd. 27, H.1, NB10 Tiranë, mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese, në lidhje me këtë regjistrë, është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

KUSHTET E BLERJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE

Investitorët apo mbajtësit e kuotave kanë të drejtë që të kërkojnë blerjen apo shlyerjen e kuotave duke u paraqitur pranë selisë së Shoqërisë Administruese, nëpërmjet degëve të saj dhe rrjetit të kompanisë mëmë SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, për të nënshkruar formularët përkatës të blerjes ose shlyerjes së kuotave. Forca shitëse përbëhet nga staf i trajnuar dhe i autorizuar për shitje nga Shoqëria Administruese.

Blerja e kuotave

Blerja e kuotave të fondit të investimeve nga investitori nënkupton miratimin e kushteve të kontratës së administrimit të Fondit të Investimeve, të parashikuara në rregullat dhe prospektin e fondit.

Blerja e kuotave në Fond kryhet nëpërmjet:

- Pagesës së vlerës monetare. Blerësi/investitori futet në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila ka detyrim të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet, parimet dhe kriteret e shpallura në prospekt;

Çdo pagesë për blerje kuotash kryhet në llogarinë bankare të Fondit me IBAN AL37 2101 1012 0000 0000 0300

të hapur pranë depozitarit, i cili është ABI Bank, Shqipëri, nëpërmjet:

- Transfertave nga llogaria e investitorit pranë bankës depozitare ose çdo banke tjetër të nivelit të dytë (të ndryshme nga Banka Amerikane e Investimeve) drejt llogarisë së Fondit tek depozitari (kundrejt tarifave në fuqi).

Të gjithë investitorët që konsiderojnë apo janë të gatshëm të blejnë kuota në Fond nëpërmjet pagesës së aseteve monetare, duhet të nënshkruajnë një kërkesë për blerje kuotash (urdhër-blerje) në mënyrë që të bëhet pronar i një numri të caktuar kuotash në momentin që kryen pagesën në favor të llogarisë së Fondit.

Periudha e investimit nis në momentin e mbërritjes së pagesës në fond dhe zgjat deri në ditën e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitjen e kuotave në Shoqërinë Administruese.

Çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në Fond konsiderohet ai i blerjes së kuotës nga investitori, i llogaritur në përputhje me ligjin nr. 56/2020, datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, rregulloret në zbatim të tij, si dhe në përputhje me këtë prospekt.

Asnjë kuotë nuk mund të shitet ose të shlyhet me çmim tjetër përveç çmimit të ardhshëm të llogaritur pas marrjes së urdhrorit për blerjen ose shitjen e kuotave.

Në rastet kur kërkesa për blerjen e kuotave nga klienti mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste zyrtare, çmimi i blerjes së kuotave do të konsiderohet ai i ditës së parë pasardhëse të punës.

Numri i kuotave në Fond përcaktohet me 4 shifra pas presjes dhjetore.

Shlyerja e kuotave

Mbajtësi i kuotave ka të drejtë të kërkojë në çdo moment shitjen e kuotave të tij nëpërmjet plotësimit të një formë kërkesë për shitje të kuotave të Fondit.

Shlyerja e kuotave ekzekutohet nga Shoqëria Administruese duke përdorur çmimin e zbatueshëm në datën e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për këtë veprim.

Asnjë kuotë nuk mund të shitet me çmim tjetër përveç çmimit të ardhshëm të llogaritur pas marrjes së urdhrorit për shitjen e kuotave.

Afati për shlyerjen e kuotave është maksimumi 7 ditë kalendarike nga mbërritja e kërkesës për shitje.

Në momentin e shlyerjes asetet monetare të investitorit do të kalojnë nga llogaria e fondit të investimit pranë bankës depozitare drejt llogarisë së investitorit.

Në rastet kur kërkesa për shlyerjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste zyrtare, dita e kërkesës së vlefshme për shitje do të jetë dita e parë pasardhëse e punës.

Në raste të veçanta kur shitja e aseteve të Fondit, e nevojshme për të plotësuar kërkesat për shlyerjen në vlera të mëdha, mund të komprometojë dhe rrezikojë pozicionin e investitorëve të përhershëm në Fond, shlyerja e kuotave mund të bëhet duke përdorur drejtpërdrejt asete nga portofoli i Fondit në mënyrë propocionale me numrin e kuotave të cilat kërkohet të shlyhen me vlerën totale të aseteve të Fondit.

Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes së kuotave

Bazuar në ligjin për SIK nr. 56/2020 datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” seksioni 5 Neni 114 “Pezullimi i shitjes dhe i shlyerjes” të miratuar nga AMF, shitja dhe shlyerja e kuotave në Fond, mund të pezullohet në rastet kur sipas gjykimit të Shoqërisë Administruese dhe depozitarit, kjo është e nevojshme për të mbrojtur interesat e mbajtësve të kuotave të fondit.

Nëse Shoqëria Administruese vendos ta pezullojë emetimin dhe shlyerjen e kuotave dhe nëse depozitari nuk është dakord me këtë vendim, ai njofton menjëherë autoritetin.

AMF nga ana e saj vlerëson apo konsideron se Fondi ndodhet në situatën ku ka shkaqe të forta dhe të mirë-justifikuara që të urdhërojë Shoqërinë Administruese dhe Depozitarin të pezullojë përkohësisht shitjet dhe shlyerjet, në mbrojtje të interesave të mbajtësve ekzistues ose potencial të kuotave. Shkaqet mund të jenë: a) rezultat papajtueshmërie ligjore e rregullatore nga inspektimet rutinë b) vlerësim i pasaktë i aktiveve c) vërtetohet rast mashtrimi apo neglizhence ç) verifikohet mungesë transparence me investitorin, mos- informim lidhur me Prospektin si dhe Informacionin Kryesor d) rrethana të caktuara cilësuese jashtë kontrollit të Fondit apo AMF-se dh) përballja e Fondit me një fluks shumë të lartë tërheqjesh detyron Fondin të likuidojë asete, rast i cili vë seriozisht në rrezik investitorët e tjerë në sipërmarrje. AMF publikon në faqen zyrtare të saj, arsyet dhe kohëzgjatjen e pezullimit, në rastet kur kjo e fundit dihet.

Çdo pezullim i shitjes dhe shlyerjes së kuotave, i njoftohet menjëherë autoritetit nga Shoqëria Administruese, së bashku me një informacion orientues se kur do të rifillojë shlyerja. Informacioni për pezullimin e shlyerjes së kuotave publikohet menjëherë nga shoqëria administruese në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

Autoriteti urdhëron shoqërinë administruese për ta rifilluar shitjen dhe shlyerjen e kuotave, nëse ka arsye për të besuar se kjo është e nevojshme në interes të mbrojtjes së publikut ose të mbajtësve të kuotave.

Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes merr fund sapo përfundojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, por jo më vonë se brenda njëzet ditëve pune nga pezullimi, me përjashtim të rastit kur autoriteti ka dhënë pëlqimin me shkrim për shtyrjen e këtij afati.

Shoqëria administruese informon autoritetin menjëherë me të rifilluar shitjen dhe shlyerjen dhe rifillimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave publikohet menjëherë nga shoqëria administruese në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

Transferimi i kuotave

Shoqëria administruese do të lejojë transferimin e kuotave të investitorit në përputhje me parashikimet e nenit 117 të ligjit nr. 56/2020 si dhe aktet e tjera ligjore dhe rregullative.

Çdo akt transferimi në lidhje me kuotat e fondit nënshkruhet nga investitori që zotëron kuotat në fond ose përfaqësuesi i subjektit juridik dhe transferuesi trajtohet si pjesëmarrës në fond deri në momentin kur marrësi i kuotave të jetë regjistruar nga Shoqëria Administruese dhe depozitari. Transferimi i kuotave është subjekt tatimi sipas legjislacionit në fuqi.

VLERËSIMI I ASETEVE DHE ÇMIMIT TË KUOTËS

Vlerësimi i aseteve, detyrimeve të fondit dhe çmimit të kuotës bëhet në bazë ditore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit www.fondisigal.com.al.

Depozitari kontrollon dhe konfirmon llogaritjen e këtyre vlerave dhe mban përgjegjësi për saktësinë e rezultatit të tyre. Metoda e përdorur për vlerësimin e aseteve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 56/2020, datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, në rregulloret e miratuara nga AMF si edhe në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në metodologjinë “Për llogaritjen e vlerës neto të aseteve të dhe Fondit të Investimeve në lekë” të përcaktuar nga Shoqëria Administruese dhe Depozitari, portofoli i titujve për tregtim dhe/ose i vlefshëm për shitje do të rivlerësohet çdo ditë pune, duke zbatuar parimin e çmimit të tregut për çdo titull i cili tregtohet aktivisht në Bursë apo tregje të rregulluara.

Në kushtet e një tregu jo-aktiv të letrave me vlerë, rivlerësimi bëhet duke u mbështetur në yield-in deri në maturim i cili llogaritet me metodën e interpolimit linear sipas yield-ëve më të fundit të ankandëve të bonove të thesarit apo obligacioneve dhe ditëve të mbetura deri në maturim të letrës me vlerë.

Në kushtet e një tregu aktiv të letrave me vlerë.

Asetet e Fondit të cilat janë të listuara dhe tregtohen në një treg aktiv do të vlerësohen me vlerën e drejtë. Çmimi i tregut në një treg aktiv garanton dëshminë më të besueshme të vlerës së drejtë dhe përdoret për të matur vlerën e drejtë. Rrjedhimisht, asetet e fondit që klasifikohen nga Shoqëria si të tregtuara në një treg aktiv do të vlerësohen me çmimin e fundit në dispozicion të tregut në momentin e vlerësimit.

Asetet të cilat nuk tregtohen në treg aktiv por që janë identike me asete që kuotohen në treg aktiv, do të përdoren çmimet e fundit të aseteve të kuotuar në treg aktiv në momentin e vlerësimit.

Të ardhurat e interesit nga depozitat do të llogariten në bazë ditore, por pagesa do të bëhet në datën e maturimit të depozitës. Baza për llogaritjen e interesit është 365 ditë dhe si rregull i përgjithshëm, interesi fillon në datën e emetimit.

Çdo depozitë me datën e emetimit T dhe maturitet në datën N, do të gjenerojë interes nga data T deri në datën (N-1), por pagesa e interesit nga pala tjetër do të jetë në datën N.

Kuotat e fondeve të tjera të investimit do të rivlerësohen me vlerën neto të aseteve për kuotë të fondit përkatës, sipas çmimit zyrtar të disponueshëm në ditën e vlerësimit.

Në rastin kur vlera neto e aseteve për kuotë nuk është publikuar ose nuk është e disponueshme në ditën e vlerësimit, kuotat e mbajtura në fondet e tjera të investimit do të rivlerësohen me çmimin më të fundit të publikuar për atë fond.

Vlera e kuotës së Fondit për ditën e vlerësimit (T-1) përcaktohet duke pjesëtuar vlerën neto të aseteve të Fondit në lekë formuar deri në përfundim të ditës së punës ditë (T-1) me numrin e përgjithshëm të kuotave për atë ditë (T-1). Ky numër llogaritet duke i zbritur numrin e kuotave të shlyera në ditën e vlerësimit (T-1) dhe duke i shtuar numrin e kuotave që Fondi ka shitur në ditën e vlerësimit (T-1), numrit të përgjithshëm të kuotave në ditën para ditës së vlerësimit (T-2).

Çmimi Final=(Vlera Totale e Aseteve në ditën (T-1)-Detyrimet) / Nr. i kuotave në ditën (T-1) Gjatë ditës (T) kryhet vlerësimi i aseteve neto të Fondit për kuotë për ditën (T-1).

Asetet e ditës (T-1) do të vlerësohen deri në përfundim të operacioneve të asaj dite në orën 16:00.

ADMINISTRIMI I FITIMIT PËR MBAJTËSIT E KUOTAVE

Kuotat e Fondit janë kuota akumulimi, që do të thotë kuota për të cilat të ardhurat nga investimi ri-investohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave. Fitimi nga investimi në fond reflektohet në rritjen e çmimit të kuotës.

Investitori mund ta tërheqë fitimin nëpërmjet shitjes së plotë ose të pjesshme të kuotave, në përputhje me dispozitat ligjore dhe këtë prospekt.

PARIMET PËR EKZEKUTIMIN MË TË MIRË TË MUNDSHËM PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM

Shoqëria Administruese do të veprojë në interesin më të mirë të investitorëve të Fondit kur ekzekuton vendime tregtimi për administrimin e Fondit. Në këtë kuadër, Shoqëria do të ndër marrë çdo veprim nën autoritetin e saj për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm për Fondin.

Më poshtë listohen kriteret për arritjen e rezultateve më të mira të mundshme për asetet e Fondit:

- Çmimi;
- Kostot/komisionet;
- Mundësia e ekzekutimit dhe mundësia e shlyerjes;
- Shpejtësia e ekzekutimit;
- Madhësia dhe natyra e urdhrit;
- Çdo konsideratë tjetër që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit për tregtim.
- Objektivat e investimit, politika e investimit, dhe risqet e Fondit;

INFORMIMI I INVESTITORËVE

Bazuar në ligjin për SIK nr. 56/2020 datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” seksioni 9 Neni 123, dhe në nenin 24 të rregullores nr.133, datë 30/09/2020 “Mbi komunikimin me investitorët”, Shoqëria Administruese ka detyrim për të vendosur në dispozicion prospektin aktual, dokumentin me informacione kryesore për investitorin dhe raportet më të fundit vjetore dhe të ndërmjetme dhe pasqyrat financiare, sipas kërkesës për secilën sipërmarrje të veçantë të investimeve kolektive me ofertë publike që ka në administrim.

Të gjitha këto raporte, rregullat e Fondit dhe çdo informacion shtesë do të vihen në dispozicion të investitorëve pranë zyrave qendrore të shoqërisë administruese në adresën: Rr. Ukraina e Lirë, Pallati i ri Teknoprojekt, Tiranë, pas një kërkesë me shkrim, ose nëpërmjet postës elektronike info@fondisigal.com.al.

Të gjitha informacionet e mësipërme, së bashku vlerën e asetëve neto dhe me çmimin e kuotës do të publikohen rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese. Frekuenca e publikimit të vlerës së asetëve neto dhe çmimit të kuotës është në bazë ditore.

Nëse ka ndryshime thelbësore në prospekt, njoftimi për ndryshimet e propozuara u dërgohet drejtpërdrejtë me postë normale ose postë elektronike të gjithë mbajtësve të kuotave dhe publikohet në faqen e internetit të Shoqërisë Administruese gjatë 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pune, përpara ditës së implementimit të ndryshimeve.

Investitori, për çdo ndryshim në të dhënat e tij të kontaktit, duhet të njoftojë Shoqërinë Administruese. Të gjithë mbajtësit e kuotave të fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur njoftohen se kanë të drejtë të kërkojnë nga fondi shlyerjen e kuotave të tyre, pa zbritur asnjë komision daljeje të aplikueshëm dhe shlyerja e të gjitha kuotave, sipas kërkesave të dorëzuara kryhet para implementimit të ndryshimeve në prospektin SIK. Sa më sipër në referencë të ligjit 56/2020 datë 30/04/2020.

TARIFAT DHE KOMISIONET

Tarifa e Administrimit

Tarifa e Administrimit pasqyrohet si përqindje e vlerës neto të aktiveve të Fondit. Kjo tarifë do të jetë 1.5 % (një pikë pesë përqind) e vlerës neto të aktiveve të Fondit.

Tarifa e administrimit përlllogaritet çdo ditë dhe zbritet nga asetet e fondit, ndërsa pagesa e saj për shoqërinë administruese kryhet një herë në muaj.

Formula e llogaritjes ditore të tarifës së administrimit është:

Tarifë vjetore e raportuar e administrimit /365

Tarifat të Tjera

Komisione/tarifa të njehershme (përpara ose pas investimit)

Tarifa e hyrjes në Fond	0 %	Nuk aplikohet tarifë hyrjeje
Tarifa e daljes nga Fondi	0 %	Nuk aplikohet tarifë daljeje

Komisionet bankare të transferimit të fondeve nga shlyerja e kuotave janë përgjegjësi e investitorit. Shoqëria Administruese nuk mban përgjegjësi për komisionet bankare që shoqërojnë investimin apo daljen nga fondi. Shoqëria Administruese do të bëjë përpjekje maksimale për uljen e kostove të transferimit të fondeve me palët e përfshira në proces.

KOMISIONE/TARIFA TË TJERA QË PAGUHEN NGA ASETET E FONDIT

- Tarifa e Depozitarit- 0.18% e Vlerës neto të aseteve në terma vjetore
- Tarifa Rregullatore AMF- 0.05% e Vlerës së përgjithshme të aseteve të fondit në terma vjetore
- Komisione për shit-blerjen e aseteve të Fondit-në varësi të Kushteve të Punës të tregut ku kryhet transaksioni^[1]
- Tarifa e Auditimit vjetor të Fondit- në varësi të marrëveshjes që lidhet midis shoqërisë administruese dhe kompanisë.

[1] *Shoqëria Administruese do të zgjedhë në çdo rast, alternativën më të mirë të realizimit të transaksionit dukeatur parasysht kostot e aplikuara.

KOMISIONE/TARIFA QË PAGUHEN NGA MBAJTËSIT E KUOTAVE (INVESTITORI)

- Kostot e shpërndarjes së raporteve dhe pasqyrave financiare
- Kostot e shërbimit të mbajtësve të kuotave (komisionet bankare për transferta nga llogaria bankare e investitorit drejt llogarisë së fondit (hyrje në fond) si dhe transferta nga llogaria bankare e fondit drejt llogarisë së investitorit (dalje nga fondi), paguhen nga vetë investitori.

Kostoja totale vjetore e shfrytëzimit të sipërmarrjes me ofertë publike nuk është më e madhe se 3,5 % e vlerës neto të aktiveve të sipërmarrjes.

Shpenzimet zbriten nga të ardhurat apo asetet e SIK në bazë ditore dhe diferenca e cila ndryshon çmimin e kuotës shpërndahet në mënyrë proporcionale me numrin e kuotave në fond deri në momentin e përlllogaritjes.

Shoqëria Administruese mund të ndryshojë tarifën e Fondit në përputhje me Ligjin nr. 56/2020, datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe rregulloret të dala në zbatim të tij.

Çdo ndryshim tarifash do të reflektohet në ndryshime në prospektin e Fondit, i cili miratohet paraprakisht nga AMF dhe i njoftohet mbajtësve të kuotave në përputhje me ligjin dhe me këtë prospekt. Tarifat ose shpenzimet e fondit pakësojnë vlerën neto të aseteve të fondit dhe si rrjedhojë ndikojnë në çmimin e kuotës së fondit.

TRAJTIMI FISKAL

Fondi, për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aseteve, si dhe personi i fundit që përfiton prej saj, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin tatimor. Të gjitha fitimet e realizuara nga investimi në fond, do të taten sipas legjislacionit tatimor në fuqi në momentin e shlyerjes së kuotave. Tatimi mbahet në burim nga shoqëria administruese.

Shënim: Shoqëria Administruese rekomandon që investitorët të konsultohen me këshilltarë të fushës fiskale për vlerësuar situatën e tyre tatimore, e cila mund të jetë subjekt ndryshimi në të ardhmen në varësi të ndryshimeve në legjislacionin tatimor ose akteve të tjera nënligjore të administratës Tatimore.

AUDITI I JASHTËM

Shoqëria Administruese llogaritë e veta dhe të Fondit që administron, krahas strukturave të kontrollit të brendshëm dhe administrimit të rrezikut, i auditon çdo vit dhe në afate të ndërmjetme edhe nga Auditues të Jashtëm.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a., ka auditues të jashtëm kompaninë audituese Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k. e cila është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Pricewaterhousecoopers Assurance Services Sh.p.k. ka zyrën qendrore në adresën Rr.Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9/1, Tiranë, e regjistruar në regjistrin tregtar me nr. fiskal L92014010J, me nr. Regjistri 701 në regjistrin e audituesve ligjorë.

Tel: 04 229 0700

E-mail: al_pwc_albania@pwc.com Web: <https://www.pwc.com/al>

Personat përgjegjës:

Laureta Këlliçi (Administratore)

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

DEPOZITARI

Në zbatim të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, asetet e fondit të investimit, mbahen tek një depozitar i vetëm, i cili duhet të jetë një bankë e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për kryerjen e shërbimeve të kujdestarisë dhe e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer veprimtarinë e Depozitarit.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a., ka lidhur marrëveshje kujdestarie për shërbimin e depozitarit me bankën “Abi Bank” me seli në adresën : Rruga e Kavajës Nd. 27, H.1, NB10 Tiranë. Kjo bankë, do të ofrojë shërbimet e kujdestarisë, të depozitimit dhe të besimit për asetet e fondit.

Depozitari Abi Bank është një entitet ligjor i rregulluar , licencuar dhe mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë sipas licencës me nr.14 datë 28/10/1999. Mban dhe licencën si Depozitar i Fondit të Pensioneve dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me vendimin nr.92, datë 03/07/2017.

Llogaria e derdhjeve të kontributeve të Fondit të Investimeve SIGAL INVEST, pranë ABI BANK është:
Lekë AL37 2101 1012 0000 0000 0300

Aktivet e Fondit, që përfshijnë llogaritë bankare si dhe aktive të llojeve të tjera, ruhen dhe mbahen nga Depozitari në një llogari të posaçme dhe nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për:

- kryerjen e transaksioneve për llogari të tij, ose
- të marrë ndonjë përfitim për vete a punonjësit e tij, ose
- qëllime të tjera, të ndryshme nga ato të përfitimit të mbajtësve të kuotave

Asetet e Fondit që mbahen nga Depozitari gëzojnë të drejtën e veçimit dhe nuk përfshihen në asetet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, që gjejnë zbatim sipas legjislacionit shqiptar dhe as për zbatimin e pretendimeve të të tretëve ndaj depozitarit.

Depozitari vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave të Fondit.

Krahas ruajtjes së aseteve të Fondit, depozitari kryen, ndër të tjera, edhe veprimtaritë e mëposhtme:

- garanton se shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave janë në përputhje me ligjin dhe aktin themelues të sipërmarrjes;
- siguron se vlera neto e aktiveve të kuotave ose njërive të sipërmarrjes është llogaritur në përputhje me ligjin, aktet rregullative të miratuara nga AMF në bazë të ligjit dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;
- përmbush dhe zbaton udhëzimet e shoqërisë administruese nëse nuk bien ndesh me ligjin, aktet rregullative të miratuara nga AMF në bazë të ligjit ose me aktin themelues të sipërmarrjes;
- garanton kthimin e çdo shume përkatëse sipërmarrjes, brenda afateve kohore të përcaktuara lidhur me transaksionet që përfshijnë aktivet e sipërmarrjes;
- garanton se të ardhurat e sipërmarrjes përdoren në përputhje me ligjin dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;

- garanton që flukset monetare të sipërmarrjes monitorohen si duhet, në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga investitorët, ose në emër të investitorëve, me nënshkrimin e kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike dhe se të gjitha mjetet monetare të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të Sipërmarrjes, Shoqërisë Administruese për llogari të Sipërmarrjes ose të Depozitarit për llogari të Sipërmarrjes; si edhe garanton dhe merr masat e nevojshme për të siguruar që fondet e sipërmarrjes SIK të depozituara pranë një banke qendrore, një banke në Republikën e Shqipërisë apo një banke të licencuar në një vend tjetër mbahen në një llogari ose disa llogari të identifikuara më vete nga çdo llogari e përdorur që i përkasin fondeve të Depozitarit apo fondeve dhe klientëve të tjerë të Depozitarit.
- emeton e anulon kuotat dhe paguan paratë e shlyerjes mbajtësve të kuotave, sipas udhëzimeve të Shoqërisë Administruese, kur këto udhëzime janë në përputhje me ligjin, me aktet rregullative të miratuara nga AMF në zbatim të ligjit dhe me aktin themelues të sipërmarrjes;
- mban regjistrin e mbajtësve të kuotave dhe shërbimet e transferimit për fondet e investimeve me ofertë publike;
- i raporton AMF për çdo shkelje të ligjit dhe kontratës nga Shoqëria Administruese, në rast se kjo Shoqëri refuzon të pranojë kërkesën e tij për ndërprerjen e kësaj shkeljeje.

Në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore, Depozitari raporton çdo ditë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare përpara orës 12:00, parametrat kryesore të fondit që janë: vlera neto e aseteve, numri i kuotave dhe çmimi i kuotës.

Konflikti i interesit

Në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, depozitari nuk kryen veprimtari lidhur me Sipërmarrjen e Investimeve Kolektive me ofertë publike ose me Shoqërinë Administruese që administrojnë Sipërmarrjen e Investimeve Kolektive me ofertë publike, të cilat mund të shkaktojnë konflikt interesi ndërmjet Sipërmarrjes së Investimeve Kolektive me ofertë publike, investitorëve të kësaj sipërmarrjeje, Shoqërisë Administruese dhe vetë Depozitarit, me përjashtim të rastit kur Depozitari ka bërë një ndarje funksionale dhe hierarkike të kryerjes së detyrave të Depozitarit nga detyrat e tjera që përbëjnë konflikt dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme dhe u bëhet i ditur investitorëve të Sipërmarrjes së Investimeve Kolektive me ofertë publike.

BASHKIMI DHE MBYLLJA E FONDIT**Bashkimi i fondit me një fond tjetër**

Bashkimi fondeve të investimeve me ofertë publike kryhet sipas parashikimeve ligjore si më poshtë:

- të gjitha të drejtat dhe detyrimet në një ose më shumë fonde të investimeve me ofertë publike që bashkohen i kalohen një fondi ekzistues marrës të investimeve me ofertë publike. Mbjtësit e kuotave në fondet pjesëmarrëse në bashkim marrin kuotat në ose fondin marrës dhe fondet pjesëmarrëse në bashkim prishen; ose
- të gjitha të drejtat dhe detyrimet në një ose më shumë fonde që bashkohen i kalohen një fondi marrës të krijuar rishtazi, mbajtësit e kuotave në fondet pjesëmarrëse në bashkim marrin kuotat në fondin marrës dhe fondet pjesëmarrëse në bashkim prishen.

Mbjtësit e kuotave në fondet që bashkohen përfitojnë një vlerë të barasvlefshme kuotash në fondin pjesëmarrës në bashkim në datën e bashkimit. Për të arritur këtë, nëse është e nevojshme, mbajtësve të kuotave mund t'u ofrohen pagesa të vogla kompensuese në para.

Autoriteti miraton paraprakisht çdo bashkim të fondeve të investimeve me ofertë publike. Për miratimin është e nevojshme firmosja e projekt marrëveshjes për bashkim, konfirmimi nga depozitarët, draft informacioni që do t'u dërgohet mbajtësve të kuotave, prospekti SIK dhe dokumenti me informacionin kryesor për investitorin për fondin marrës, dhe dokumentacioni që dëshmon se është lidhur marrëveshja me depozitarin dhe audituesin. Mbjtësit e kuotave të sipërmarrjeve bashkuese dhe marrëse kanë të drejtë t'i shlyejnë kuotat e tyre pa pagesë ose t'i këmbëjnë kuotat e fondit që do të bashkohet me kuota të një fondi tjetër me natyrë të ngjashme investimi, i cili administrohet nga e njëjta shoqëri administruese. E drejta e shlyerjes dhe këmbimit të kuotave është e vlefshme deri në 5 (pesë) ditë punë, përpara datës së hyrjes në fuqi të bashkimit.

Mbyllja e fondit

Shoqëria Administruese mund të nisë mbylljen e Fondit, kur krijohen rrethana të parashikuara në ligjin nr.56/2020, datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe në mënyrë të veçantë kur:

- AMF i ka hequr në mënyrë të përkohshme apo permanente licencën shoqërisë administruese;
- Shoqëria administruese i nënshtrohet procedurave të falimentit dhe rrjedhimisht likuidimit si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve;
- Shoqëria administruese mbyll me vullnetin e saj aktivitetin;

Mbyllja e Fondit të investimit si rregull kryhet nga Shoqëria Administruese, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- Në rast se kjo shoqëri është në proces falimenti, ose kur AMF i ka pezulluar përkohësisht ose ka revokuar në mënyrë permanente licencën e saj, atëherë mbyllja realizohet nga Depozitari i Fondit.
- Nëse Depozitari është në proces falimenti ose kur licenca e tij si Depozitar dhe/ose si Bankë

është pezulluar përkohësisht apo është i/u është revokuar në mënyrë permanente, mbyllja e Fondit do të realizohet nga një likuidues fondi, i caktuar nga AMF.

Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve i paraqitet AMF-së, jo më pak se 3 muaj, përpara datës së propozuar të likuidimit së bashku me arsyet e kërkesës dhe një plan kohor për likuidimin.

Shoqëria harton pasqyrën e aftësisë paguese, e cila konfirmon që fondi është në gjendje të përmbushë të gjitha detyrimet brenda 12 muajve nga data e hartimit të kësaj pasqyre. Mbjajtësit e kuotave informohen lidhur me likuidimin vullnetar pas dhënies së miratimit nga AMF.

Ky informacion përfshin:

- arsyet e likuidimit;
- pasojat e mundshme për mbajtësit e kuotave;
- kostot përkatëse;
- pasqyrat e aftësisë paguese;
- datën e planifikuar të përfundimit të likuidimit vullnetar, përfshirë datën kur mbajtësit e kuotave do të kenë pagesën e vlerës së kuotave

VITI FINANCIAR AKTUAL

Viti financiar aktual për Fondin fillon më 19/02/2024 dhe përfundon më 31/12/2024.

Për vitet pasardhëse, viti financiar i fondit do të jetë viti përkatës kalendarik, që fillon në Janar e përfundon në Dhjetor.

INFORMACION PLOTËSUES

Informacioni në këtë Prospekt bazohet në ligj dhe në praktikat me të mira. Çdo person që lexon këtë Prospekt, duhet të verifikojë pranë Shoqërisë Administruese se ky është versioni më i fundit dhe se nuk janë bërë rishikime apo ndryshime të tjera që nga momenti që ky Prospekt ka dalë në qarkullim.

Konflikti i interesit

Shoqëria Administruese parandalon konfliktin e interesit që lind në lidhje me veprimtarinë e saj tregtare. Kjo Shoqëri ndërmerr të gjithë hapat e arsyeshëm për të identifikuar dhe monitoruar konfliktin e interesit që lind në lidhje me administrimin e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive. Në zbatim të ligjit 56/2020 datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe të akteve në zbatim të tij kjo përfshin konfliktin e interesit midis:

- shoqërisë administruese të fondeve, përfshirë punonjësit e drejtuesit e saj dhe personat me të cilët ka lidhje pronësie ose një subjekt i lidhur i saj dhe çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive nën administrim të shoqërisë administruese të fondeve dhe investitorëve në këtë sipërmarrje;
- sipërmarrjes së investimeve kolektive ose investitorëve në këtë sipërmarrje dhe një klienti tjetër të shoqërisë administruese të fondeve;

- sipërmarrjes së investimeve kolektive ose investitorëve në këtë sipërmarrje dhe çdo sipërmarrjeje të investimeve kolektive nën administrim të shoqërisë administruese të fondeve ose investitorëve të kësaj sipërmarrjeje;
- dy klientëve të shoqërisë administruese të fondeve.

Kujdesi

Administrimi i portofolit të fondit kryhet nëpërmjet një gjykimi të matur e të kujdesshëm, i parë në të njëjtin këndvështrim të atij të administrimit të financave dhe investimeve personale të vetë personelit kyç i cili ka në ngarkim këtë funksion. Përpjekje maksimale e transparente kryhen për të maksimizuar ruajtjen e kapitalit të investitorëve me aplikimin e masave prudenciale të rrezikut pa prapaska arbitrazhi e spekulimi, por me synim përfitimi të pastër nga investimi.

“FATCA” dhe “CRS/Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare”

Në zbatim të Ligjit nr.4, datë 30/01/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” Shoqëria Administruese është plotësisht e angazhuar për të përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe Aktin për Përputhshmërinë Tatimore të Llogarive të Huaja (“FATCA”).

Gjithashtu, Shoqëria Administruese në kuadër të përpjekjeve kombëtare dhe globale për të luftuar praktikën e fshehtësisë së të ardhurave nëpërmjet mbajtjes dhe menaxhimit të investimeve në institucione financiare jashtë vendeve të rezidencës, do të bashkëpunojë pa rezerva me të gjithë autoritetet tatimore vendase dhe të huaja.

Për të qenë në përputhje me legjislacionin fiskal të kërkuar nga SHBA, fondi do të regjistrohet në Agjencinë Kombëtare të të Ardhurave (IRS), konkretisht në FATCA (Foreign Account Tax Compliance Act) me status “Institucion Financiar i Huaj (FFI) Pjesëmarrës”. Bazuar në kërkesën e Investitorëve, Shoqëria Administruese do të njoftojë këta të fundit për numrin Unik GIIN për qëllime raportimi në FATCA.

Ankesat

Çdo ankesë mund ta dërgoni me shkrim në adresën e Shoqërisë Administruese: Rr. "Ukraina e Lirë", pas Kullave Binjake, ndërmjet Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë, Shqipëri. Afati për shqyrtim të të gjitha ankesave dhe kthim përgjigjeje brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes në dorëzim të tyre.

Aneks 1

Rregullat e fondit të investimit SIGAL Invest

Neni 1

Rregullat e Fondit

1.1 Rregullat e Fondit rregullojnë kushtet e veprimtarisë së Fondit të Investimit SIGAL INVEST (në vijim referuar si “Fondi”, një Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike e veçantë, i themeluar nga Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a., si dhe marrëdhëniet ligjore ndërmjet e kuota-mbajtësve në Fond (në vijim referuar si “Investitorët”).

1.2 Rregullat e fondit nuk përmbajnë detyrimisht të gjithë informacionin dhe të dhënat të paraqitura në Prospekt. Investitorët këshillohen të studiojnë të gjithë përmbajtjen e Prospektit.

Neni 2

Veprimtaria e Fondit

Objekti i veprimtarisë së Fondit është akumulimi i aseteve monetare ose të klasifikuara të ngjashme me to nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, të cilat investohen në asete sipas përcaktimeve në këtë Prospekt duke ndjekur gjithashtu parime të diversifikimit të risqeve apo portofolit. Investitorët kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë proporcionale në fitimet e fondit, si dhe të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre, sipas dispozitave të Ligjit nr. 56/2020, datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” (në vijim “Ligji”) si dhe Prospektit.

Neni 3

Krijimi i Fondit

3.1 Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar dhe fillon veprimtarinë e tij më datë 19/02/2024.

3.2 Prospekti i Fondit është miratuar nga Këshilli i Administrimit i Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive “SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA” sh.a., më datë 28/02/2023, si dhe është miratuar nga AMF me vendim nr. 18, datë 28/02/2023.

Neni 4

Monedha e Fondit

Monedha bazë e Fondit është “Lekë” e cila nënkupton se çdo blerje dhe shlyerje e kuotave kryhet në monedhën Lekë.

Neni 5

Pjesëmarrja

5.1 Çdo person mund të blejë kuota në Fond, duke hyrë në një marrëdhënie ligjore/kontraktuale, me Shoqërinë Administruese.

5.2 Shoqëria administruese përllëgarit dhe publikon çdo ditë vlerën e kuotës. Llogaritja e vlerës neto të aseteve dhe çmimit të kuotës kontrollonhet dhe verifikohet nga Depozitari, institucion/funksion përgjegjës për saktësinë e këtyre llogaritjeve.

5.3 Çdo investitor në momentin e blerjes së kuotave nënshkruan një kontratë dhe në këtë mënyrë konfirmon se është njohur dhe ka rënë dakord me përcaktimet në Prospekt dhe Rregullat e Fondit.

Neni 6

Investimet

Objektivi i investimit të Fondit është maksimizimi i kthimit nga investimi nëpërmjet administrimit të asetëve, për një rritje të të ardhurave të investitorit në një periudhë afatmesme duke ruajtur principalin dhe nivelet e mjaftueshme të likuiditetit.

Kthimi përbëhet nga të ardhurat nga interesat e investimeve, fitimi apo humbja nga rivlerësimi i kapitalit duke përfshirë dhe të ardhurat nga aktiviteti i tregtimit të titujve. Fondi është fond akumulimi i cili i ri-investon të ardhurat e gjeneruara nga asetet e tij.

Një ndër treguesit që merret në konsideratë në vendimin për investim është kohëzgjatja emodifikuar e portofolit e cila i referohet mesatares së ponderuar të treguesve të ndjeshmërisë së çmimit të letrave me vlerë individuale që përbëjnë portofolin e investimeve.

Instrumentat e mëposhtëm të investimit blihen për asetet e fondit, në përputhje me fokusin e investimit të parashtruar më lart.

Deri në 10% të asetëve të fondit në ekuivalentë “cash”-i, transaksione të anasjellta të riblerjes dhe depozita bankare me maturitet deri në 12 muaj;

Deri në 90% të asetëve të fondit në tituj borxhi qeveritarë të emetuar ose garantuar nga Republika e Shqipërisë;

Deri në 30% të asetëve të fondit në tituj borxhi të emetuara nga organet e Qeverisjes Vendore dhe nga shoqëri tregtare vendase, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë;

Deri në 5 % të asetëve të fondit Tituj të transferueshëm dhe instrumente të tjerë financiarë të borxhit që tregtohen në tregje të rregulluara, në një shtet të Bashkimit Europian, apo në shtete të lejuara nga AMF;

Deri në 5% të asetëve të fondit në fonde investimi me fokus në tituj borxhi të emetuarnë monedhën vendase;

Neni 7

Investimi minimal

Shuma minimale e investimit fillestarë është 10,000 Lekë dhe minimumi i investimeve në vazhdim është 10,000 Lekë.

Neni 8

Huamarrja

Fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur mund të blejnë valutë të huaj me anë të huamarrjes së ndërsjellë (back to back loans).

Fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, mund të marrin hua me kusht që huamarrja të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Në baza të përkohshme, jo më shumë se 90 ditë, dhe nuk përbën më shumë se 10% të vlerës neto të aktiveve të fondit;

b) Me anë të marrëveshjeve të riblerjes (repo).

Neni 9

Të drejtat dhe përgjegjësitë e investitorëve në Fond

Investitorët në Fond kanë të drejtat e mëposhtme:

- a) Të kenë pronësinë e kuotave dhe të pajisen me certifikatën e pronësisë (sipas kërkesës);
- b) Të materializojnë fitimin e tyre nëpërmjet shitjes së plotë ose të pjesshme të kuotave;
- c) Të kontribuojnë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të;
- d) Të informohen periodikisht (raporte periodike sipas kërkesës);
- e) Të kërkojnë shitjen e pjesshme apo të plotë të kuotave në çdo kohë;
- f) Asetet e tyre të jenë objekt i së drejtës së veçimit në rast falimenti të Shoqërisë Administruese;
- g) Investitorët kanë përgjegjësi të limituar për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në Fond.
- h) Kanë të drejtën e transferimit të kuotave

Neni 10

Shlyerja e kuotave

10.1 Investitorët kanë të drejtë të kërkojnë në çdo moment shitjen e kuotave që kanë në pronësi të tyre nëpërmjet një kërkesë për shitje.

10.2 Shlyerja e kuotave në Fond bëhet nga Shoqëria Administruese jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitje.

Neni 11

Depozitari

11.1 Shoqëria administruese ka lidhur një kontratë me ABI BANK me seli në adresën: Rruga e Kavajës Nd. 27, H.1, NB10 Tiranë, e cila do të ofrojë shërbimet e Depozitarit përasetet e Fondit në përputhje me ligjin nr. 56/2020, datë 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

11.2 Pjesë integrale e rregullave të fondit është edhe Deklarata e Kujdestarisë e Depozitarit.

Neni 12

Kontabiliteti

Shoqëria Administruese përpilon pasqyrat dhe raporte të tjera financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e pranuar të SNRF.

Neni 13

Kontrolli dhe Auditimi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë Administruese kontrollohen nga ekspertët kontabël të autorizuar të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 14

Ruajtja e Konfidencialitetit

Personat kyç, personeli kyç dhe punonjësit e Shoqërisë Administruese të fondeve trajtojnë si konfidencial dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, çdo informacion mbi pjesëmarrësit që mund të marrin dijeni për shkak të detyrës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe me akte ligjore dhe nënligjore. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet edhe për personat që kryejnë detyra në emër të Shoqërisë Administruese të fondeve, përfshirë subjektet të cilave u është deleguar në zbatim të nenit 25, të ligjit, si dhe punonjësit e tyre. Dispozitate kësaj pike nuk zbatohen për rastet e mëposhtme:

- a) kur mbajtësi i aksionit ose kuotës në fond shprehet dakord me shkrim për përhapjen e disa të dhënave të caktuara konfidenciale;
- b) kur të dhënat i kërkon AMF, gjykata ose një autoritet tjetër rregullator në funksion të një procedure të kryer brenda kompetencave të tij dhe për këtë i jep subjektit kërkesë meshkrim për informacionin;
- c) kur të dhënat i bëhen të ditura shoqërisë mëmë lidhur me mbikëqyrjen, në përputhje me këtë ligj ose në përputhje me ligjin që rregullon grupimet financiare.

Sa më sipër në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 56/2020 dt. 30/04/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.

Neni 15

Shoqëria Administruese dhe detyrimet

Shoqëria administruese gjatë administrimit të fondit ka detyrimet e mëposhtme:

- a) Të menaxhojë Fondin në linjë me objektivat e investimit të parashikuara në prospekt;
- b) Të krijojë dhe të mirëmbajë regjistrin e kuotave për çdo investitor;
- c) Të depozitojë në një depozitar të vetëm çdo veprim me asetet, në emër dhe për llogaritë Fondit;
- d) Të ndjekë procedurat e përcaktuara në Ligj dhe prospekt lidhur me proceset e shitjes së kuotave të Fondit;
- e) Të shlyejë në kohën dhe në mënyrën e duhur të gjitha detyrimet monetare;
- f) Të informojë periodikisht investitorët, sipas parashikimeve në prospekt;
- g) Të garantojë konfidencialitet maksimal të të dhënave nën administrim;
- h) Të vendosë në dispozicion të investitorëve pa pagesë kopje fizike të Prospektit para lidhjes së kontratës për blerjen e kuotave;
- i) Të publikojë kopje elektronike të Prospektit në faqen e saj të internetit www.fondisigal.com.al ;
- j) Të publikojë në faqen e saj zyrtare vlerën e aseteve neto dhe çmimin e kuotës.

Neni 16

Tarifat e Shoqërisë Administruese

Shoqëria Administruese aplikon një tarifë administrimi për të gjithë investitorët në fond, e cila do të jetë 1.5% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.

Shoqëria Administruese nuk aplikon tarifë hyrëse dhe dalëse nga fondi;

Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohet nga Shoqëria Administruese, do t’u njoftohet investitorëve të paktën 2 muaj përpara, sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Prospektin e Fondit.

Tarifa e Administrimit e cila u ngarkohet mbajtësve të kuotave të Fondit të investimit SIGAL INVEST është 1.5% në vit e vlerës neto të aktiveve të fondit dhe për llogaritë çdoditë sipas formulës:

Tarifa vjetore e administrimit/365

Komisione/tarifa të tjera që paguhen nga asetet e fondit

-Tarifa e Depozitarit- 0.18% e Vlerës neto të aseteve në terma vjetore

- Tarifa Rregullatore AMF- 0.05% e Vlerës së përgjithshme të asetëve të fondit në termavjetore
- Komisione për shit-blerjen e asetëve të Fondit-në varësi të Kushteve të Punës të tregut kukryhet transaksioni[1]

[1] *Shoqëria Administruese do të zgjedhë në çdo rast, alternativën më të mirë të realizimit të transaksionit duke patur parasysh kostot e aplikuar.

Tarifa e Auditimit vjetor të Fondit- në varësi të marrëveshjes që lidhet midis shoqërisë administruese dhe kompanisë së auditimit pas miratimit nga AMF.

Komisione/tarifa që paguhen nga mbajtësit e kuotave (investitori)

- Kostot e shpërndarjes së raporteve dhe pasqyrave financiare
- Kostot e shërbimit të mbajtësve të kuotave (komisionet bankare për hyrjen dhe daljen nga fondit)

Kostoja totale vjetore e shfrytëzimit të sipërmarrjes me ofertë publike nuk është më e madhe se 3,5 % e vlerës neto të aktiveve të sipërmarrjes.

Shpenzimet zbriten nga të ardhurat apo asetet e SIK në bazë ditore dhe diferenca e cila ndryshon çmimin e kuotës shpërndahet në mënyrë proporcionale me numrin e kuotave në fond deri në momentin e përlogaritjes.

Neni 17

Ri-shikimet dhe miratimet e Rregullave të Fondit

17.1 Rregullat e Fondit miratohen nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese.

17.2 Rregullat e Fondit i bashkëngjiten prospektit dhe bëjnë pjesë integrale të tij.

17.3 Ndryshimet dhe shtesat në rregullat e Fondit, do të miratohen paraprakisht nga Këshilli i Administrimit si dhe do të marrin miratimin e AMF-së në përputhje me dispozitatë Ligjit.

Neni 18

Të tjera

18.1 Mosmarrëveshjet cilat mund të lindin si rezultat i zbatimit apo interpretimi i këtyre rregullave, do të zgjidhen në bazë të legjislacionit shqiptar.

18.2 Rregullat e Fondit do të hyjnë në fuqi në datën e miratimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Aneks 2

DEKLARATA E KUJDESTARIT

Bazuar në Ligjin 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” në cilësinë e Depozitarit të Fondit të Investimit SIGAL INVEST

Deklaroj:

Pasuria e sipërmarrjes së investimeve kolektive, do të ruhet nga Depozitari për llogari të investitorëve, duke respektuar parimin e barazisë, në përputhje me numrin e kuotave që zotëron çdo investitor, ose në rastin kur ekzistojnë njëkohësisht si kuota të ardhurash, ashtu edhe kuota akumulimi, në përputhje me pjesën individuale në pasurinë e sipërmarrjes, e llogaritur në bazë të kuotave të zotëruara nga çdo investitor.

Shumat, që ndodhen në llogarinë e parave për t'u shpërndarë, mbahen nga Depozitari vetëm për qëllime shpërndarjeje.

Monedha bazë e Fondit është LEK-u.

Viti Financiar i Fondit për vitin 2025, fillon më datë 01/01/2025 dhe përfundon më datë 31/12/2025.

Depozitari : ABI BANK

Përfaqësuesi/t i/e Autorizuar:

.....

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv Tiranë, 2025

Aneks 3

DEKLARATA E INVESTITORIT

Datë:

Unë, i/e nënshkruari/a _____ deklaroj se i kam lexuar dhe kuptuar kushtet e ofertës dhe risqet e përfshira.

Investitori

(Emër, Mbiemër, Firmë)

FORMULAR I BLERJES SËKUOTAVE NË FONDIN E INVESTIMIT SIGAL INVEST

INFORMACION I RËNDËSISHËM

- Investitori duhet të ketë lexuar dhe kuptuar Prospektin dhe Rregullat e Fondit përpara se të angazhohet në blerjen e kuotave dhe investimin në fondin e investimit SIGAL INVEST.
- Investimi ekzekutohet në momentin e mbërritjes e pagesës në llogarinë e Fondit pranë Bankës Depozitare.
- Investimi i klientit do të konvertohet në kuota duke zbatuar çmimin e kuotës në datën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e Fondit pranë Bankës Depozitare. Çmimi përlllogarit në përputhje me Ligjin nr. 56/2020, “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Çdo seksion i këtij dokumenti është i kërkuar dhe duhet plotësuar ku është i aplikueshëm.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR INVESTITORIN

Për të blerë kuota në Fond, ky dokument duhet të jetë i shoqëruar me një mjet identifikues (pasaportë/kartë identiteti) si dhe adresën e vendbanimit të investitorit. Në rast të mungesës së njërit prej dokumenteve të mësipërm, transaksioni nuk mund të procesohet. Në rast se forma plotësohet nga një person i tretë, me formularin duhet gjithashtu të bashkëngjitet një dokument identifikues i personit që korrespondon me personin e tretë të deklaruar nga investitori, si dhe prokura që autorizon përfaqësimin.

INFORMACION RRETH INVESTITORIT

Emri: _____ Atësia: _____ Mbiemri: _____

Emri i plotë i Biznesit/ Shoqërisë: _____

Gjinia: Mashkull Femër Nuk Aplikohet Datëlindja: _____/_____/_____

Vendlindja: _____ Shtetësia: _____

Adresa/ Selia e biznesit : _____

Lloj i Dokumentit Identifikues: _____

Autoriteti Lëshues: _____

NIPT/NUIS: _____

Nr.i Dokumentit Identifikues: _____

Numri Personal i Identifikimit: _____

Data e Lëshimit: __/__/_____

Data e Skadimit: _____/_____/_____

Rezidenca Fiskale: _____

Data e regjistrimit në QKB: _____/_____/_____

Kohëzgjatja: _____

Adresa e Vendbanimit: _ Tel: _____

Adresa e Korrespondencës: _____ E-Mail: _____

Vendi i Punësimit: _____

Pozicioni i Punës: _____

Ortakët e Shoqërisë: _____

Përfaqësuesi Ligjor i Kompanisë:

Objekti i Aktivitetit: _____

Statusi i Kompanisë: _____

INFORMACION RRETH PERSONIT TË TRETË QË INVESTON NË EMËR TË INVESTITORIT

Emri: _____ Atësia: _____ Mbiemri: _____ Gjinia:
 Mashkull Femër Nuk aplikohet
 Datëlindja: ____/____/_____
 Vendlindja: _____ Shtetësia: _____ Lloji Dokumentit Identifikues: _____
 _____ Autoriteti Lëshues: _____
 Nr.i Dokumentit Identifikues: _____ Numri Personal i Identifikimit: _____
 _____ Data e Lëshimit: __/__/_
 Data e Skadimit: ____/____/____ Residenza Fiskale: _____
 Adresa e Vendbanimit: _ Tel: _____
 Adresa e Korrespondencës: ____ E-Mail: _____
 Vendi i Punësimit: _____ Pozicioni i Punës: ____

INFORMACION RRETH INVESTITORIT

Pagesë e menjëhershme Plan Investimi
 Frekuenca e pagesave në Planin e Investimit: _____
 Shuma e investuar: _____
 Kohëzgjatja e parashikuar mbi investimin: _____

BURIMI I TË ARDHURAVE TË INVESTITORIT

Ju lutemi të konfirmoni burimin e të ardhurave për investimin në fond:

 Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se investimi i këtyre fondeve vjen nga një burimi një aktiviteti të ligjshëm dhe se ky investim do të shërbejë vetëm për qëllime të ligjshme.

DEKLARATË E INVESTITORIT:

Unë i nënshkruari _____ deklaroj:

Kam marrë, kam lexuar dhe kuptuar si dhe bie dakord me Dokumentin, Prospektin, Informacionin Kryesor për Investitorin (KIID) dhe Rregullat e Fondit të investimit SIGAL INVEST, i cili administrohet nga Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të investimeve Kolektive SIGAL Life Uniqa Group Austria sh.a. (në vijim shoqëria administruese). Deklaroj se kam lexuar, plotësuar dhe kuptuar pyetësonin e rrezikut dhe jam njohur me profilin tim të rrezikut si investitor.

Jam i vetëdijshëm që investimi që po ndërmarr nuk është i garantuar. Nënshkrimi i këtij urdhri nënkupton hyrjen në një marrëdhënie ligjore me fondin e investimit SIGAL INVEST. Ky investim është bërë me dëshirën, vullnetin dhe gjykimin tim të plotë dhe deklaroj se jam vënë në dijeni rreth kushteve të ofertës dhe tarifave në lidhje me blerjen dhe shitjen e kuotave në fondin e investimit SIGAL INVEST.

Unë kam kuptuar se të dhënat e mia personale të deklaruara në këtë dokument ose çdodokument tjetër të nënshkruar apo deklaruar janë të dhëna të detyrueshme, si dhe do të përpunohen nga shoqëria administruese në respekt me standardet më të larta të sigurisë në përputhje të plotë me ligjin, nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si edhe në përputhje me parashikimet e bëra në "Rregulloren e Përgjithshme Evropiane Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" GDPR, vetëm për qëllim ofrimit e produkteve ose përmbushjen edetyrimeve ligjore të cilat janë bazuar në akte ligjore dhe rregullative të Republikës së Shqipërisë.

Kuptoj se është detyrimi im të përditësoj këto të dhëna ne rast se do të ndryshohen. Deklaroj se informacioni i dhënë nga ana ime në këtë aplikim është i vërtetë dhe i saktë. Unë jap aprovimin tim që shoqëria administruese, të mbledhë të dhënat e mia personaletë deklaruar në këtë dokument, si edhe t'i përpunojë më tej ato për qëllime të ofrimit tëshërbimeve për të cilat unë po aplikoj.

Deklaroj se jam i njohur me të drejtën time që në çdo kohë:

- Mund t'i kërkoj shoqërisë administruese, që të korrigjojë ose të ndryshojë të dhënat emia personale me anë të një kërkesë paraprake të dokumentuar;
- Mund të ankothem tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Mund të tërhiqem nga dhënia e pëlqimit për përpunim e të dhënave.

Autorizoj në mënyrë të shprehur shoqërinë administruese, që të ruajë të dhënat e mia personale për një afat deri në 11-vite pas mbylljes së marrëdhënies së biznesit mes meje dhe shoqërisë administruese. Jam njohur nga Shoqëria me faktin që për çdo pyetje apo informacion lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave të mia personale kam të drejtë të dërgoj e-mail në adresën elektronike: info@fondisigal.com.al.

Jap miratimin tim të pakushtëzuar që shoqëria administruese mund të përdorë të dhënat e mia personale për qëllimin që unë të përfitoj nga ofertat promovionale, si pjesë e paketës së produkteve/shërbimeve që ofrohen apo mund të ofrohen në të ardhmen, nëpërmjet kanaleve të informimit (mesazhe telefonike, telefonata, postë elektronike dhe postë zyrtare).

Autorizoj shoqëria administruese, që duke respektuar standardet më të larta të sigurisë dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të delegojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave të mia

personale, duke i transferuar këto të dhëna tek palë tjetra të specializuara për këtë qëllim. Në këtë kuadër, jam njohur me faktin që të dhënat mia personale i transferohen ABI Bank sh.a., në cilësinë e Depozitarit të Fondit bazuar në Ligjin nr 56/2020, “Për sipërmarrjet e Investimeve kolektive” i ndryshuar, në mënyrë që shoqëria të ushtrojë vigjilencën e duhur si edhe të zbatojë detyrimet e tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.

Deklaroj se jam njohur me të drejtën që në çdo kohë të kërkojë nga shoqëria administruese revokimin e këtij miratimi.

Data e paraqitjes së kërkesës:

Vendi:

__/__/____

Investitori/Personi i Autorizuar

SIGAL UNIQA INVEST

Emër mbiemër : _____

Emër mbiemër :

Firmë/Vula e Subjektit:

Firmë/Vula e Subjektit:
